



Monitorimi i gjykrimeve administrative 2015

Në gjykatat administrative të shkallës së parë
dhe Gjykatën e Apelit Administrativ



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Monitorimi i gjkimeve administrative 2015

Në gjykatat administrative të shkallës së parë dhe
Gjykatën e Apelit Administrativ



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Përmbajtja

i.	Lista e shkurtimeve	8
ii.	Lista e tabelave dhe grafikëve	9
iii.	Përmbledhje	11
iv.	Hyrje	13
I.	KUADRI NORMATIV NDËRKOMBËTAR DHE VENDAS	17
	1.1. Standardet ndërkombëtare	17
	1.2. Kuadri ligjor vendas	17
II.	METODOLOGJIA	23
	2.1. Përzgjedhja e çështjeve	24
	2.2. Formulari i monitorimit	25
	2.3. Sasia dhe llojet e çështjeve të monitoruara	25
III.	GJETJET DHE MANGËSITË E VËREJTURA	27
	3.1. Aksesi në gjykata	27
	3.1.1. Vëzhgime të përgjithshme	27
	3.1.2. Kalendari i çështjeve	28
	3.1.3. Sportelet e informacionit	28
	3.1.4. Hapësira e gjykatave	31
	3.1.5. Hyrja fizime në gjykatë dhe kushtet për persona me aftësi të kufizuara	31
	3.1.6 Aksesi fizik në gjykatë dhe lehtësirat për personat me aftësi të kufizuar	32
	3.1.7 Regjistrimi i seancave	33
	3.2. Kohëzgjatja e gjykimeve	34
	3.2.1. Vëzhgime të përgjithshme	34
	3.2.2. Kohëzgjatja e gjykimeve, mesatarja e seancave dhe vonesa të vërejtura në gjykatat e shkallës së parë	34

3.2.3. Seancat produktive përkundrejt atyre jorproduktive në gjykatat e shkallës së parë	35
3.2.4. Gjykimi i çështjeve në Gjykatën e Apelit Administrativ	38
3.3. Barazia e armëve, paraqitja e provave dhe përfaqësimi ligjor	41
3.3.1. Vëzhgime të përgjithshme	41
3.3.2. Detyrimi i gjykatës për të vendosur masa ndëshkuese ndaj organeve publike që nuk paraqesin prova	42
3.3.3. Dëshmia e palëve dhe dëshmitarëve	43
3.3.4. Roli i gjyqtarëve për të informuar palët mbi historikun procedural, përfaqësimin ligjor dhe të drejtën për ndihmë ligjore pa pagesë	44
IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	48
REKOMANDIME	50
Shtojcë – Formulari i monitorimit të gjykimit administrativ (varianti në dokument word-i i formularit elektronik online të hartuar nga Prezenca)	53

Mirënjohje

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dëshiron të shprehë mirënjohjen e saj ndaj të gjithë atyre që kontribuan për përgatitjen e "Raportit të Monitorimit të Gjytimeve Administrative" për vitin 2015. Mbështetja nga gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe kryetarët përkatës të këtyre gjykatave, kancelarët, trupat gjyqësore, nëpunësit ka qenë domethënëse për të përmbushuar veprimtaritë e parashikuara në projekt, të cilat kanë paraprirë përgatitjen e këtij raporti.

Ky është raporti i parë i hartuar nga Prezenca për vlerësimin e kuadrit ligjor dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë administrative në Shqipëri, i cili vepron që prej datës 4 nëntor 2013.

Grupi vëzhgues i gjytimeve administrative përbëhej nga një vëzhgues për secilën gjykatë administrative të shkallës së parë dhe të Gjykatës së Apelit Administrativ. David Laflamme, Këshilltar i Lartë Ligjor, pranë Prezencës së OSBE-së në Shqipëri hartoi formularin e vëzhgimit të gjykimit administrativ bazuar në modelin e paraqitur në Manualin për Monitorimin e Drejtësisë Administrative.¹ Drejtuesja e projektit, Iris Petrela, dhe Këshilltari i Lartë Ligjor, Emir Kamenica, grumbulluan të dhënat nga formularët, i analizuan në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi, si dhe me aktet e standardet ndërkombëtare dhe hartuan raportin. Linda Dikolli ofroi ndihmë në nxjerrjen e statistikave nga formularët elektronikë që ishin plotësuar nga vëzhguesit. Gjithashtu, Pietro Sardaro, Shef i Departamentit të Ligjit dhe i të Drejtave të Njeriut, Catherine Fischl, Këshilltare e Lartë e Gjyqësorit, si dhe Joana Karapataqi, Këshilltare Vendase e Çështjeve me Publikun dhe e Raportimit, ofruan ndihmën e tyre në përgatitjen e këtij raporti.

Prezenca e zhvilloi veprimtarinë vëzhguese në përputhje me metodologjinë e monitorimit të përgatitur nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike

1. Handbook for Monitoring Administrative Justice, botim i përbashkët i ODIHR dhe Folke Bernadotte Academy, 2013

dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR).² Së fundi, Prezenca dëshiron të shprehë mirënjohje për Qeverinë e Republikës Federale Gjermane për kontributin financiar që mundësoi vëzhgimin e gjykimeve administrative dhe Akademinë Folke Bernadotte, Suedi, për kontributin e çmuar financiar që mundësoi botimin e këtij raporti.

2. ODIHR Trial Monitoring: A Reference Manual for Practitioners, 2008, botim i rishikuar, 2012, gjendet në: <http://www.osce.org/odihr/item/1130849.html>

i. Lista e shkurtimeve

KPA	Kodi i Procedurës Administrative
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
FBA	Akademia Folke Bernadotte, Suedi
KNDCP	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
LGJA	Ligj nr. 49/2012, "Për organizimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar
LNJ	Ligj nr. 10039, "Për ndihmën juridike", datë 22.12.2008, i ndryshuar
MD	Ministria e Drejtësisë
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
Prezenca	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezenca në Shqipëri
Dekret Presidential	Dekret i Presidentit të Republikës nr. 7818, datë 16.11.2012, "Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të Apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative"
Kushtetuta	Ligj nr.8417, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", datë 21.10.1998, i ndryshuar

ii. Lista e tabelave dhe grafikëve

Tabela nr.1	Llojet e çështjeve të monitoruara në gjykatat administrative të shkallës së parë
Tabela nr.2	Mesatarja e seancave për çështjet e përfunduara me vendim gjatë vëzhgimit
Tabela nr.3	Seancat produktive përkundrejt atyre joproduktive
Tabela nr.4	Arsyet për shtyrjen e seancave gjyqësore
Tabela nr.5	Ankimet për çështjet e vëzhguara
Grafiku nr.1	Respektimi i afateve për paraqitjen e raporteve nga ekspertët
Grafiku nr. 2	Vendosja e masave ndëshkuese nëse palët nuk zbatojnë urdhërat e gjykatës për paraqitjen e provave
Grafiku nr.3	Dëshmitë e palëve në gjykimet administrative
Grafiku nr.4	Deklarimet e dëshmitarëve në gjykimet administrative
Grafiku nr.5	Shpjegimi i historikut procedural të çështjes nga gjyqtarët në fillim të seancës
Grafiku nr.6	Përfaqësimi ligjor

iii. Përmbledhje

Pas miratimit të Ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" ("LGJA"), nisi të funksionojë sistemi i ri i drejtësisë administrative në Shqipëri, me gjashtë gjykata të specializuara të shkallës së parë dhe një gjykatë apeli, në përputhje me rregullat e reja të gjykit të cilat hynë në fuqi në nëntor të vitit 2013. LGJA-ja përmban dispozita që synojnë përmirësimin e efikasitetit të proceseve duke mbrojtur në të njëjtën kohë të drejtat e palëve për gjykim të drejtë. Në veçanti, ky ligj përpiqet të sigurojë barazi të armëve në procese ku shteti ka zakonisht qasje më të madhe në burime dhe informacion.

Ky raport bazohet në analizën e të dhënave të grumbulluara gjatë monitorimit të 159 çështjeve administrative, të kryer nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në periudhën maj - dhjetor 2015. Monitorimi kishte për qëllim të vlerësonte nëse sistemi i ri i gjykatave administrative vepron në përputhje me standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë dhe me LGJA-në. Gjithashtu, Prezenca ofron 18 rekomandime për përmirësimin e sistemit të drejtësisë administrative.

Në lidhje me kohëzgjatjen e gjykit, Prezenca vërejti që gjykimi i çështjeve në gjykatat e shkallës së parë ishte arsyeshëm i shpejtë, çka tregon se rregullat e reja të gjykit, të cilat kanë për qëllim përshpejtimin e proceseve, janë të efektshme. U vërejtën edhe seanca joproduktive, por përgjithësisht ndodhnin për arsye që shkonin përtej kontrollit të gjyqarit.

Infrastruktura që mund të ofronte qasje të efektshme në gjykata u pa si e pamjaftueshme. Me përjashtim të Gjykatës Administrative të Apelit të Tiranës, nuk ishte e mundur të merrej informacion *online* rreth seancave të ardhshme dhe kalendaret javore nuk ishin të standardizuara. Mungesa e sallave të disponueshme të gjykit bënte që seancat të mbaheshin në dhomat e gjyqtarëve, të cilat nuk janë të pajisura me regjistrim audio dhe ku publiku nuk mund të marrë pjesë, duke ulur kështu nivelin e transparencës.

20% e palëve ndërgjyqëse nuk ishin të përfaqësuar dhe vetëm një përqindje e vogël e tyre përdorën ndihmën juridike, me gjasa prej mungesës së njohurive se u takon një gjë e tillë.

Edhe pse çështjet u gjykuan në kohë në shkallë të parë, një gjë e tillë nuk ndodhi në shkallën e apelit. Planifikimi i seancave dhe gjykimi i çështjeve në të vetmen Gjykatë Administrative të Apelit ka prirje të zgjatet dhe të shkelë afatin 30 ditor që përcakton LGJA-ja për gjykimin e çështjeve të apeluara. Për arsye të këtyre vonesave, Prezenca pati mundësi të monitoronte vetëm një numër tejet të kufizuar seancash në shkallën e apelit dhe nuk pati mundësi të monitoronte fazën e ekzekutimit, çka do të thotë se nuk mund të pasqyroheshin gjetje dhe nuk mund të jepeshin rekomandime për këtë aspekt. Pavarësisht kësaj, raporti ofron një bazë të dobishme për përmirësimin e rregullave të gjykimin dhe të strukturës së sistemit të gjykatave administrative kur në të ardhmen të shqyrtohet mundësia për ndryshime ligjore.

iv. Hyrje

E drejta administrative drejton veprimtaritë e organeve administrative qeveritare, përfshirë regjistrimin civil, lëshimin e licencave të biznesit, mbrojtjen e mjedisit, shpronësimin, planifikimin urban, funksionimin e ndërmarrjeve publike dhe qasjen në informacion. Autoritetet administrative janë përballja kryesore ndërmjet personave privatë (individë ose ligjorë), nga njëra anë dhe shtetit, nga ana tjetër dhe si të tilla ato përcaktojnë në mënyrë të efektshme të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë.³ Aktet administrative ndikojnë jetën e përditshme, prandaj është e rëndësishme që personat privatë të kenë të drejtë të apelojnë vendimet administrative që prekin të drejtat apo interesat e tyre.⁴

Ekzistenca e një sistemi të drejtësisë administrative është element thelbësor i një shoqërie që bazohet në shtetin e së drejtës. Kjo nënkupton angazhimin ndaj parimit që qeveria dhe administrata e saj duhet të veprojnë brenda fushës së autoritetit ligjor. Gjithashtu, nënkupton të drejtën e personave privatë për të kërkuar zgjidhje kuptimplota me anë të nisjes së proceseve administrative kurdo që të drejtat e tyre preken nga veprimet e administratës publike.⁵ Gjykata duhet të ketë të fuqinë për të shqyrtuar ligjshmërinë dhe/ose përshtatshmërinë e akteve administrative dhe për të ndërmarrë masa të cilat mund të ekzekutohen brenda një periudhe kohore të arsyeshme. Në këto kushte nevojitet të arrihet ekuilibër ndërmjet interesave të ligjshëm të të gjitha palëve dhe administrimit publik eficient dhe të efektshëm.⁶

Një sistem i ri gjykatash administrative me tre shkallë dhe me rregulla të reja të gjykimit, parashikuar në Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative (LGJA), u prezantua në Shqipëri në nëntor të vitit 2013. Qëllimi ishte që aktet administrative të mund të shqyrtoheshin nga një sistem kompetent dhe i pavarur gjykatash, me procedura që përputhen me standarde të gjykimit të

3. Handbook for Monitoring Administrative Justice, botim i përbashkët i ODIHR and Folke Bernadotte Academy, 2013, fq.11

4. Po aty.

5. OSCE, Copenhagen Document, 1990, paragrafët 5.10 & 5.11

6. Shih shënimin nr. 3

njohura ndërkombëtarisht. Pritej që prezantimi i këtij sistemi të ri do të çonte në zhvillime pozitive si më poshtë, të cilat do të rrisnin besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë:

- Përmirësim të cilësisë së gjykimeve në lidhje me aktet administrative
- Më pak vonesa në proceset që kanë të bëjnë me akte administrative
- Ekzekutim të përsheptuar dhe më të efektshëm të vendimeve të gjykatës
- Garantim i të drejtës për gjykim të drejtë për qytetarët.⁷

Në vazhdim të mbështetjes për përgatitjen e legjislacionit për krijimin e gjykatave të reja administrative, Prezenca mbështeti veprimtaritë fillestare duke ju ofruar gjyqtarëve të emëruar rishtazi seminare për drejtësinë administrative. Prezenca botoi gjithashtu një manual për drejtësinë administrative dhe vazhdoi t'iu ofronte mbështetje këtyre gjykatave me anë të veprimtarive për rritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve të gjykatës administrative dhe ndihmësve ligjorë të tyre përgjatë viteve 2013-2015.

Në fillim të vitit 2014, Prezenca nisi të monitoronte çështje administrative në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në Tiranë për të vlerësuar zbatimin e LGJA-së. Prezenca grumbulloi gjithashtu të dhëna rreth llojeve të vendimeve të apeluara në Gjykatën Administrative të Apelit. Më tej, midis muajve tetor dhe dhjetor të vitit 2014, Prezenca ndërmori një monitorim më të plotë të të gjashtë gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të Gjykatës Administrative të Apelit. Pas përfundimit të këtij monitorimi, u ra dakord që nevojitej një periudhë më e gjatë monitorimi për të vlerësuar më mirë zbatimin e LGJA-së nga gjykatat administrative të sapokrijuara.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri monitoroi procese administrative në të gjashtë gjykatat administrative të shkallës së parë nga muaji maj i vitit 2015 deri në fundin e muajit nëntor të vitit 2015, si dhe në Gjykatën Administrative të Apelit nga muaji maj i vitit 2015 në maj të vitit 2016. Ky raport është rezultat i këtij monitorimi.

Ky raport ka për qëllim të theksojë drejtimitet ku mund të përmirësohet

7. Manual për Drejtësinë Administrative, autore Xhaferllari Marsida, botuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Tiranë, 2014, fq.13

performanca e tyre, si dhe është i rëndësishëm për angazhimin e Prezencës në raport me gjykatat administrative në të ardhmen. Monitorimi i drejtësisë administrative lidhet drejtpërsëdrejti me angazhimin afatgjatë të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së për të siguruar shqyrtim të efektshëm gjyqësor të vendimeve administrative. Ndihma e ofruar ndaj autoriteteve shqiptare për reformën e sistemit gjyqësor⁸ dhe mbështetja për funksionimin e gjykatave të reja administrative kanë qenë pjesë e mandatit të Prezencës përgjatë dekadës së fundit.

Pjesa vijuese e këtij raporti është strukturuar si më poshtë: Kapitulli i parë ofron një panoramë të përmbledhur të standardeve ndërkombëtare të zbatueshme për proceset administrative dhe kuadrin ligjor të Shqipërisë për krijimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e çështjeve administrative. Më tej, parashtrojmë metodologjinë e përdorur për përzgjedhjen dhe monitorimin e çështjeve administrative në shkallë të parë, e cila bazohet në Manualin për Monitorimin e Drejtësisë Administrative.⁹

Kapitulli i tretë analizon të dhënat e grumbulluara nga vëzhguesit në sallat e gjyqit përkundrejt standardeve përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare dhe pasqyron mungesat përkatëse.

Kapitulli i fundit prezanton përfundimet dhe ofron rekomandime për të trajtuar mungesat e vërejtura në gjykimet administrative në gjykatat e shkallës së parë dhe në Gjykatën e Apelit Administrativ.

8. OSCE Parliamentary Assembly Decision Nr. 588, Mandati i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri 2003, gjendet në <http://www.osce.org/albania/19295>, paragrafët 2-3.

9. Shih shënimin nr. 3

KAPITULLI

1

Kuadri ligjor ndërkombëtar dhe ai vendas

1.1 STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë ndërmarrë disa angazhime thelbësore në lidhje me standardet për gjykim të drejtë, shtetin e së drejtës, pavarësinë e gjyqësorit dhe të drejtat e njeriut.¹⁰ E drejta për gjykim të drejtë në drejtësinë administrative sipas të drejtës ndërkombëtare rrjedh nga konventa ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDKP)¹¹ dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ)¹². Thelbi i angazhimeve të OSBE-së në lidhje me drejtësinë administrative ndodhet në Dokumentin e Kopenhagenit të vitit 1990, ku Shtetet pjesëmarrëse deklaruan se **“mjetet e efektshme të zgjidhjeve ndaj vendimeve administrative” janë “pjesë të atyre elementeve të drejtësisë të cilat janë thelbësore për shprehjen e plotë të dinjitetit të qenësishëm dhe të të drejtave të barabarta dhe të pandryshueshme të të gjithë qenieve njerëzore”**. Më tej thuhet se vendimet administrative duhet të jenë të arsyetuara dhe të justifikuara dhe duhet të bëjnë të qartë se cilat janë mundësitë për ndreqje.

1.2 KUADRI LIGJOR VENDAS

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton pavarësinë e pushtetit gjyqësor.¹³ Kushtetuta gjithashtu vendos që mund të krijohen me ligj gjykata

10. “Concluding Document of the Vienna meeting 1986 of Representatives of the Participating States of the Conference on Security and Co-operation in Europe” [Dokumenti përmbyllës i Takimit të Vienës 1986 i Përfaqësuesve të Shteteve Pjesëmarrëse të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë] Vienë, 1989, “Document of the Copenhagen Meeting of the Conference on the Human Dimension of the CSCE” [Dokumenti i Takimit të Kopenhagenit i Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë], Kopenhagen, 5 deri 29 qershor 1990

11. Neni 14(1) KNDKP

12. Neni 6 KEDNJ

13. Neni 145 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligj nr.8417, datë 21 tetor 1998, i ndryshuar

me juridiksion të veçantë.¹⁴ Shqipëria prezantoi një degë të re gjyqësore me anë të Ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (LGJA)¹⁵, i cili sanksionon krijimin e gjykatave administrative. Këto gjykata nisën të vepronin në nëntor të vitit 2013.

Sipas LGJA-së, gjykatat kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative janë gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Gjykatat administrative të shkallës së parë ndodhen në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë dhe e vetmja Gjykatë Administrative Apeli ndodhet në kryeqytet. Gjykata Administrative e Apelit përbëhet prej shtatë gjyqtarësh.¹⁶

Krijimi i gjykatave të specializuara për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative sipas procedurave të caktuara ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave ligjorë të individëve me anë të një procesi gjyqësor të drejtë dhe të kryer brenda një afati të arsyeshëm për një diapazon të gjerë çështjesh që mund të klasifikohen si administrative.¹⁷ Këto gjykata të reja duhet të përmirësojnë sjelljen e organeve të administratës publike duke i bërë ata më të përgjegjshëm dhe të kujdesshëm gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre ligjore.¹⁸ Rritja e llogaridhënies administrative do të përmirësojë gjithashtu klimën e biznesit. Sipas ligjit, administrata publike duhet të provojë që veprimet e kryera prej saj janë plotësisht të bazuara në ligje dhe fakte.¹⁹

LGJA-ja përmban si ligj material edhe rregulla procedurale. Risitë kryesore të tij janë si vijon:

14. Neni 135, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: "Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme."

15. Ligj nr.49/2012, datë 16 maj 2012, "Për organizimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar me ligjin nr.100/2014

16. Në periudhën kur u zhvillua veprimtaria e vëzhgimit të gjykatave administrative

17. Relacion për projekt ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", fq.1, gjendet në http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2013/02/RelLGJAion-gjyk.administrat_.pdf [hapur së fundmi në 1 nëntor 2016]

18. Po aty.

19. Neni 3, pika 3 i LGJA

Ndihmësit ligjorë

LGJA-ja parashikon ndihmës ligjorë për të ndihmuar gjyqtarët e gjykatave administrative.²⁰ Ata u prezantuan për të lehtësuar menaxhimin e proceseve administrative duke u përpjekur për të garantuar që proceset të kryhen brenda afateve të arsyeshëm.

Afatet për hapa procedurale dhe sanksionet e mundshme

Në varësi të llojit të mosmarrëveshjes, gjykata administrative e shqyrton atë gojarisht në seanca gjyqësore ose në bazë të akteve me shkrim nëpër salla gjyqi.²¹

Rregullat e reja të gjykimit nuk përcaktojnë një afat maksimal brenda të cilit gjykata e shkallës së parë duhet të marrë vendimin. Por, në vend të kësaj, ligji përcakton hapa specifike që duhen ndjekur dhe kohën maksimale që lejohet për secilin hap, duke i kërkuar gjykatësit që të menaxhojë çështjen në mënyrë aktive. Shembuj të këtyre hapave përfshijnë një afat 7 ditor për kohën gjatë të cilës gjyqtari/gjyqtarja mund të familjarizohet me dosjen, të përcaktojë nëse bën pjesë në juridiksionin e gjykatave administrative dhe të evidentojë ose të kryejë veprimet përgatitore përkatëse,²² si dhe afatet kohore maksimale për korrigjimin e gabimeve në padi nga paditësi, për paraqitjen e kundërshtimeve dhe kërkesat për ekspertë dhe dëshmitarë nga i padituri. Afatet kohore janë strikte dhe, në disa rrethana, gjyqtari mund të vendosë sanksione për përgjigje ndaj kërkesave të gjykatës. Për shembull, nëse paditësi nuk korrigjon padinë brenda periudhës kohore të përcaktuar, gjyqtari nuk pranon padinë dhe kthen provat.²³

Në çdo çështje, palët duhet të paraqesin provat përpara seancës së parë gjyqësore. Nëse organi publik paraqet një kërkesë të arsyetuar me shkrim për zgjatjen e afatit dhjetë ditor për paraqitjen e provave, gjykata duhet ta miratojë një gjë të tillë dhe afati duhet të përfundojë jo më vonë se pesë ditë

20. Neni 6 i LGJA

21. Neni 3, pika 4 i LGJA

22. Po aty.

23. Neni 25.1(a) i LGJA

përpara datës së seancës gjyqësore. Në rast mosparaqitje të provave brenda afatit të dytë, çështja vijon në bazë të provave të paraqitura. Gjithashtu, mosparaqitja e argumentave përfundimtarë nga palët përpara afatit të caktuar nga gjyqtari, nuk përbën arsye për të shtyrë shqyrtimin gjyqësor.²⁴

Çka është e rëndësishme për efikasitetin e gjykimit, mosparaqitja në gjykatë e një pale të informuar në mënyrë të përshtatshme, nuk përbën arsye për të pushuar çështjen.²⁵

Garantimi i barazisë së armëve

Për arsye të pozicionit të privilegjuar të administratës shtetërore, në procese administrative ekziston një rrezik i veçantë për shkelje të parimit të barazisë së armëve. Ankuesit mund të jenë penguar në gjykim për arsye të fshehjes së qëllimshme apo refuzimit për të ofruar akses në informacione të rëndësishme nga ana e autoritetit të paditur. LGJA-ja i jep gjyqtarit disa fuqi hetuese në çështje administrative për të siguruar ruajtje të ekuilibrit ndërmjet palëve private dhe administratës publike. Për shembull, sipas nenit 26.3 "*Në rast se organi publik nuk i paraqet provat deri në datën e seancës gjyqësore, atëherë gjykata, duke vlerësuar provat e tjera dhe rrethanat e çështjes, mund të konsiderojë të provuar faktet e pretenduara nga pala tjetër, për provimin e të cilave janë kërkuar këto prova.*"

Një tjetër dispozitë që ka për qëllim të sigurojë barazi ndërmjet palëve gjendet në nenin 35 të LGJA-së. Kjo parashikon barrën për të provuar ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe që përbën objektin e gjykimit. Gjithashtu, gjyqtari ka diskrecionin për të urdhëruar transferimin e barrës së provës së faktit nga pala individuale tek organi publik në rastet kur ka '*dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova me shkresë, që vërtetojnë se organi publik fsheh apo nuk paraqet me dashje fakte dhe prova të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.*'²⁶

24. Neni 34.6 i LGJA

25. Neni 25.3 i LGJA

26. Neni 35.3 i LGJA

Kufizimet e apelit

LGJA krijon një kategori vendimesh gjyqësore që nuk mund të apeloher në gjykatat administrative më të larta.²⁷ Këtu përfshihen vendimet në lidhje me sanksionet administrative që përbëjnë më pak se 20-fishin e pagës minimale mujore dhe ato për refuzimin administrativ për dhënien e detyrimit në të holla me vlerë më pak se 20-fishi i pagës minimale mujore.

27. Neni 45 i LGJA

KAPITULLI

2

Metodologjia

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka monitoruar gjykimet administrative në të gjashtë gjykatat administrative të shkallës së parë nga maji 2015 deri në nëntor 2015. Ky monitorim synon të vlerësojë punën e gjykatave administrative të sapongritura dhe të japë rekomandime për përmirësimin e tyre. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri e filloi monitorimin e gjykimeve në Gjykatën Administrative të Apelit njëkohësisht me ato në gjykatat e shkallës së parë, por vazhdoi deri në fund të majit 2016. Ky monitorim për një periudhë më të gjatë për gjykatën e apelit ishte i nevojshëm, duke pasur parasysh 4-8 javët që duhen për të transferuar dosjet gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit dhe kohën e nevojshme për caktimin e datave të gjyqeve dhe gjykimin e apelimeve sipas LGJA.²⁸ Pavarësisht periudhës më të gjatë, numri i çështjeve i gjykuar në shkallën e apelit gjatë periudhës së monitorimit ka qenë relativisht i kufizuar. Raporti aktual është rezultat i gjashtë muajve monitorim në gjashtë gjykatat administrative të shkallës së parë dhe i dymbëdhjetë muajve monitorim në Gjykatën Administrative të Apelit.

Prezenca punësoi dhe trajnoi shtatë vëzhgues gjyqi për të monitoruar gjashtë gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykatën Administrative të Apelit.²⁹ Prezenca punësoi edhe dy trajnues të jashtëm, të cilët, së bashku me stafin e OSBE-së, trajnuan shtatë vëzhguesit. Vëzhguesit u trajnuan për metodologjinë e monitorimit³⁰ dhe se si të përdorin Manualin për Monitorimin e Drejtësisë Administrative,³¹ përfshirë pyetësorin tip për vëzhgimin e sallës së gjyqit, i përshtatur nga Prezenca për kontekstin shqiptar. Është e rëndësishme

28. Neni 48, pika 1 i LGJA parashikon 1. Gjykata, ku është paraqitur ankimi, dërgon ankimin, së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, vendimin e gjyqtarit për pranimin e ankimit, aktet e komunikimit të ankimit, si dhe dosjen e gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Pika 2 e të njëjtit nen parashikon një afat fiks brenda të cilit Gjykata e Apelit duhet të marrë vendimin për çështjen, konkretisht: 2. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi.

29. Vëzhguesit e gjykatave kanë pasur përvojë të mëparshme me organizatat e shoqërisë civile në veprimtari që përfshinin monitorimin e gjykatave apo të zgjedhjeve të përgjithshme dhe vendore.

30. Ky trajnim u zhvillua në tetor 2014

31. Manual për Monitorimin e Drejtësisë Administrative, botim i përbashkët i ODIHR-it dhe "Akademisë Folke Bernadotte", 2013

të theksohet se vëzhguesit nuk u ngarkuan për të vlerësuar themelin e çështjeve apo të shqyrtonin dosjet, prandaj ky raport nuk përmban ndonjë mendim për drejtësinë apo ligjshmërinë e vendimeve të dhëna nga gjykatat administrative.

Çdo muaj, vëzhguesit në gjashtë gjykatat administrative të shkallës së parë plotësuan pyetëtorin për çështjet që vëzhguan, të cilat kishin përfunduar me një vendim gjyqësor. Pas marrjes së pyetësorit të plotësuar, stafi i projektit i komunikoi informacionin e nevojshëm, për çështjet e apeluara, vëzhguesit gjyqësor që punonte në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky informacion përfshinte numrin e çështjes, numrin e vendimit dhe datën kur është regjistruar ankimimi në gjykatën përkatëse shkallës së parë. Vëzhguesi për Gjykatën Administrative të Apelit më pas ka kërkuar hollësi nga zyra e informacionit në Gjykatën e Apelit për datat e këtyre çështjeve, në mënyrë që vëzhguesi të merrte pjesë, nëse Gjykata e Apelit vendoste të zhvillonte seancë të hapur.

Gjatë periudhës së monitorimit, Drejtuesi i Projektit ka vizituar çdo gjykatë administrative të shkallës së parë për të marrë përshtypje të drejtpërdrejtë nga vëzhguesit e gjykatës për marrëdhëniet e tyre me stafin përkatës të gjykatës dhe për të regjistruar ndonjë ndryshim të vërejtur prej tyre në lidhje me procedimet administrative, krahasuar me faza e parë.³² Drejtuesi i Projektit zhvilloi edhe takime me kryetarët e gjykatave, stafin e gjykatave (përfshirë ndihmësit ligjorë), gjyqtarët, kancelarët dhe sekretarët e gjykatave, për të marrë këndvështrim të thelluar për funksionimin e drejtësisë administrative në gjykatat e shkallës së parë.

2.1 PËRZGJEDHJA E ÇËSHTJEVE

Çështjet për monitorim janë zgjedhur rastësisht nga oraret e gjykatës afishuar në stendat e informacionit, ose të mbajtur në pikën e informacionit / regjistruarit në gjykatat ku stendat mungonin.³³ Përzgjedhja e çështjeve synoi që të garantojë shpërndarje të drejtë të llojeve të ndryshme të mosmarrëveshjeve administrative. Qëllimi ishte që të monitorohej një shumëllojshmëri mosmarrëveshjesh (të punës, pronës, sigurimeve shoqërore, etj.) me palë të paditur institucione shtetërore të ndryshme.

Manuali i ODIHR-it për Monitorimin e Drejtësisë Administrative dhe, në veçanti,

32. tetor - dhjetor 2014

33. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ishte e pajisur me stenda informuese nga momenti që filloi funksionimin, në nëntor 2013. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë kishte stenda informuese që nuk përdorej rregullisht për afishimin e orareve të seancave. Gjykatat e tjera administrative nuk kishin stenda informuese as në fillim dhe as u pajisën me to gjatë monitorimit.

pyetësori tip i përshtatur nga Prezenca për kontekstin shqiptar, kanë shërbyer si mjete për monitorimin e çështjeve administrative.

2.2 FORMULARËT E MONITORIMIT

Pas çdo seance, vëzhguesit e gjykatës plotësuan formularin e monitorimit të sallës së gjyqit dhe ia dorëzuan stafit të projektit. Formulari bazohet në modelin e Manualit të ODIHR/AFBA, e përshtatur për kontekstin shqiptar, duke e bërë më të shkurtër dhe të thjeshtuar. Formatin *online* i përdorur nga vëzhguesit paraqitet në Shtojcën e këtij raporti.

2.3 NUMRI DHE LLOJI I ÇËSHTJEVE TË MONITURUARA

Gjatë periudhës gjashtëmujore u monitoruan 159 çështje në të gjashtë gjykatat administrative të shkallës së parë.

Tabela më poshtë tregon se çështjet e paraqitura më shpesh para gjykatave administrative janë mosmarrëveshjet e punës, pasuar nga mosmarrëveshjet për kthimin dhe kompensimin e pronës, tatim-taksat, detyrimet doganore dhe gjobot përkatëse, licencimi për qëllime tregtare dhe përfitimi i pensionit.

Në 98% të çështjeve të vëzhguara, paditë janë bërë nga qytetarë privatë apo bizneset. Në vetëm tre raste (2%), paditësi ka qenë organ shtetëror.

TABELA NR. 1 LLOJET E ÇËSHTJEVE TË MONITURUARA NË GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË

Gjykata	Durrës	Gjirokastra	Korça	Shkodra	Tirana	Vlora	TOTAL 159
Lloji i mosmarrëveshjes administrative							
Marrëdhëniet e punës	4	5	5	16	11	4	44
Përfitimi i pensionit	4	6	2	6	3	2	23
Të drejtat e pronësisë	8	9	3	7	4	8	39
Detyrimet doganore / taksat / gjobot	3	4	3	10	4	2	26
Licencat	1	0	2	2	0	1	6
Ankesat për urdhra ekzekutimi	1	2	1	0	2	1	7
Kompensim për burgim të padrejtë	1	0	2	0	0	0	3
Korrigjim i informacionit të statusit civil	0	4	2	0	0	0	6
Kompensim për dëm kontraktual ose jokontraktual	0	2	0	2	0	1	5

KAPITULLI

3

Gjetjet dhe mangësitë e vërejtura

Ky kapitull ndahet në tre çështje kryesore: aksesit në gjykata, kohëzgjatja e procedimeve dhe barazia e armëve. Secila çështje ndahet në nënçështje. Të dhënat e nxjerra nga formularët e monitorimit paraqiten në formën e tabelave apo grafikëve, shoqëruar me interpretim dhe analizë. Secili seksion përmban në fund vëzhgimet dhe sugjerimet për korrigjime në rastet ku është evidentuar pamjaftueshmëri. Në përgjithësi, të gjithë vëzhguesit e gjykatave raportuan se gjykatat administrative kanë ngarkesë pune të konsiderueshme, çka bën që gjyqtarët të kenë seanca gjatë gjithë orarit. Gjithashtu, të gjithë vëzhguesit raportuan se monitorimi i tyre është pranuar në përgjithësi nga kryetarët, gjyqtarët, kancelarët dhe stafi i gjykatave.

3.1 AKSESI NË GJYKATA

3.1.1 Komente të përgjithshme

E drejta e aksesit në gjykata nuk është e mbrojtur shprehimisht në instrumentet ndërkombëtare. Megjithatë, GJEDNJ vlerëson se aksesit në gjykatë është pjesë e pandashme e të drejtës për gjykim të drejtë, neni 6 i KEDNJ.³⁴ Seanca duhet të zhvillohet në një vend që iu mundëson palëve pjesëmarrje efektive në gjyq. Mjediset duhet të mundësojnë akses për personat me aftësi të kufizuar, por praktika gjyqësore për këtë çështje ka qenë ngurruese.³⁵ E drejta

34. Golder kundër UK, GJEDNJ, 21 shkurt 1975, paragrafi 34; Steele dhe Morris kundër MB, GJEDNJ, 15 shkurt 2005, paragrafi 59, ku gjykata vendosi se “është shumë e rëndësishme për konceptin e gjykimit të drejtë, si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale, që palëve në gjykim të mos u mohohet mundësia që të paraqesin çështjen e tyre në mënyrë efektive përpara një gjykate (po aty) dhe që ato të jenë në gjendje të gëzojnë barazinë e armëve me palën kundërshtare [...]” faqe 100.

35. Nenet 5(3) dhe 9 të Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Promovimin e Të drejtave dhe Dinjitetit të Personave me Aftësi të Kufizuar detyron shtetet palë që t’iu mundësojnë “akomodim të arsyeshëm” personave me aftësi të kufizuar që të kenë akses në mjediset dhe shërbimet e disponueshme për të tjerët, që kërkojnë modifikime dhe rregullime të nevojshme dhe të përshtatshme që nuk përbëjnë barrë disproporcionale apo të padrejtë për shtetin. Citim nga Manuali Ligjor i Standardeve Ndërkombëtare për Gjykimin e Drejtë, botim i OSBE/ODIHR 2012, faqe 46, gjendet në <http://www.osce.org/odihr/94214> [hapur së fundmi më 31 tetor 2016]

e palëve për akses efektiv në gjykata mund të shkelet, nëse informacioni për orarin dhe vendin e seancës është i pamjaftueshëm. E drejta e aksesit kërkon edhe që shteti të marrë masa të arsyeshme për të vënë në dispozicion dokumentet dhe vendimet për palët ndërgjyqjese.³⁶ Palët në një çështje civile dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë duhet të kenë akses në të gjithë informacionin e nevojshëm, përfshirë provat dhe dokumentet e tjera që mund t'i ndihmojnë për të përgatitur plotësisht çështjen, ose që të çlirohen nga përgjegjësia. Ky akses duhet dhënë në kohën sa më të shkurtër dhe të përshtatshme.³⁷

Gjatë procesit të monitorimit të gjyqeve, të gjithë vëzhguesit raportuan se komunikimi i tyre me zyrat e informacionit, sekretaritë dhe kryetarët e gjykatave përkatëse ka qenë konstruktiv. Sa herë vëzhguesit iu janë drejtuar këtyre personave, iu është dhënë informacioni dhe sqarimet që kanë kërkuar. Në shumë raste, gjyqtarët vullnetarisht iu kanë dhënë sqarime dhe/ose informacion shtesë vëzhguesve për çështjet që kishin përzgjedhur për monitorim.

3.1.2 Vendndodhja e Gjykatave

Edhe pse janë gjashtë gjykata në mbarë vendin, vihet re se secila mbulon një zonë gjeografike relativisht të madhe dhe infrastruktura e dobët në mjaft pjesë të vendit detyron palët ndërgjyqjese që të udhëtojnë shumë orë për të marrë pjesë në seancë.

REKOMANDIMI 1: Duhet të rishikohet mbulimi gjeografik i secilës gjykatës të shkallës së parë dhe të shihet mundësia për ngritjen e degëve ose gjykatave "udhëtuese" për zonat që janë në largësi të konsiderueshme.

3.1.3 Oraret e seancave

Që nga fillimi i funksionimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka pasur disa stenda informuese brenda sallës kryesore, në hyrje të gjykatës. Gjatë periudhës së monitorimit, gjykatat e shkallës së parë në Vlorë, Shkodër, Durrës dhe Gjirokastrë, nuk përdornin stenda informuese. Gjykata

36. Ziliberg kundër Moldavisë, GJEDNJ, 1 shkurt 2005, paragrafi 40.

37. Bogonos kundër Rusisë, GJEDNJ, 5 shkurt 2004 (vendimi për pranueshmërinë) dhe Hennings kundër Gjermanisë, GJEDNJ, 23 nëntor 1992.

Administrative e Apelit ka një faqe interneti që jep informacion të saktë për ankimet e regjistruara dhe oraret e seancave, por këtë instrument nuk e ka asnjë nga gjykatat e shkallës së parë.

Monitorimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë konstatoi se oraret e seancave shtypeshin në letër dhe afishoheshin në muret e sallës së pritjes. Këto lista të seancave që do të zhvilloheshin ishin të organizuara fillimisht sipas gjyqtarit, pastaj sipas ditës, dhe pastaj sipas orarit të seancave. Mungon një model uniform për listat e seancave: disa lista fillojnë me orarin e seancës, të tjerat me numrin e çështjes, e disa të tjera me emrin e paditësit. Edhe informacioni që përmban lista ndryshon sipas gjyqtarit: disa lista kanë numrin e çështjes, llojin e seancës (përgatitore, gjykim, dhënie vendimi, etj.), ose objektin e çështjet, ndërsa të tjerat nuk e kanë. Kjo divergjencë ndërmjet listave të seancave të gjyqtarëve të ndryshëm krijon paqartësi dhe e vështirëson marrjen e informacionit për një seancë specifike. Gjithashtu, gjykata është shumë larg qendrës së qytetit, kështu që qytetarët duhet të udhëtojnë për të parë seancat e javës.

Gjykatat administrative të shkallës së parë në rrethe kanë situatë të ndryshme nga ajo e Tiranës. Gjykatat administrative në Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë ndajnë mjediset me gjykatat e tjera, sepse ndodhen në godinat ekzistuese të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të zakonshëm në qytetet përkatëse, ndërsa Gjykata e Apelit e Shkallës së Parë Durrës ndan mjediset (në të njëjtin kat) me zyrat e Shërbimit të Përmbarimit. Publiku mund të ngatërrohet kur dy institucione gjenden në të njëjtin kat, si në Durrës, si dhe ekziston rreziku që gjyqtarët dhe palët që janë në seanca gjyqësore të shpërqendrohen prej zhurmave. Vëzhguesi në Durrës raportoi se ndodhte që një kopje e orareve të gjykatës të lihej mbi karrige në sallën e gjykatës, e cila përmbante informacion për publikun në lidhje me seancat e javës. Kjo procedurë është e pamjaftueshme, sepse ka pak gjasa që palët e interesuara të shohin oraret.

Gjykatat administrative të shkallës së parë në Gjirokastrë, Korçë dhe Vlorë kanë hyrje të posaçme. Megjithatë, edhe në këto gjykata, stendat informuese nuk ekzistojnë, ose nuk përdoren për të afishuar orarin javor të gjykatës, si në rastin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ku në mur kishte një stendë informuese bosh, ngjitur me sportelin e komunikimit me publikun.

Të gjithë vëzhguesit rregullisht raportuan se arritën të merrnin kalendarin e gjykatës çdo javë, ose nga kancelarët, ose nga sekretarët, por kjo është e pamjaftueshme, sepse kalendarin e gjykatës duhet të afishohet për publikun. Ky është tregues i transparencës së gjykatës dhe element kyç për të pasur gjykim të drejtë.

Në të gjitha gjykatat e shkallës së parë në Tiranë, orari i seancave i afishuar në mur nuk tregon vendndodhjen e seancës. Prandaj, palët dhe përfaqësuesit e tyre detyrohen të presin në sallën e pritjes që të vijë sekretaria dhe të shpallë fillimin e seancës. Zakonisht, sekretaria vjen në sallën e pritjes, shpall seanca me mikrofon dhe shoqëron palët në sallën ku do të zhvillohet seanca. Salla e pritjes është e ndarë në tri hapësira të ndërlidhura, ku vetëm njëra ka mikrofon. Kjo, bashkë me zhurmën e krijuar nga numri i madh i personave që presin në sallë, e bën të vështirë për personat që presin në pjesët e tjera të sallës të dëgjojnë shpalljen. Për këtë arsye, sekretaria shpesh duhet të shkojë në të tri pjesët e sallës dhe të thërrasë emrat e palëve, që të sigurohet se e kuptuan që seanca e tyre duhet të fillojë. Meqë orari i seancave është i ngjeshur (caktohen çdo 15-30 minuta) dhe rregullisht ka vonesa, shpesh krijohet dyndje e personave në pjesën e sallës së pritjes ku gjendet mikrofonin, me qëllim që të mos e humbasin shpalljen. Kjo gjë kontribuon në kaosin e përgjithshëm të sallës së pritjes, që mund të shmanget nëse vendndodhja e secilës seance planifikohet paraprakisht dhe orari shpallet në mur.

Në gjykatat e tjera administrative të shkallës së parë, palët shpesh prisnin në sallën e gjykatës për sekretarët që të shpallnin seancën.

REKOMANDIMI 2: Të gjitha gjykatat administrative duhet të respektojnë një nivel të njëjtë transparence dhe të lehtësojnë aksesin e publikut në gjykata, duke shpallur një version të standardizuar të kalendarit të seancave (përfshirë edhe vendin/sallën e seancës, ku është e mundur) në stendat informuese dhe në faqen e internetit të gjykatës (nëse ka), çdo javë. Duhet të hartohet një rregullore e brendshme që të gjitha gjykatat administrative të përdorin një kalendar javor të standardizuar.

REKOMANDIMI 3: Të gjitha gjykatat administrative duhet të kenë faqen e internetit të tyre ose një të përbashkët, ku të jepet informacion i përditësuar dhe i aksesueshëm, përfshirë kalendarin javor të gjykatës.

3.1.4 Sportelet e informimit

Gjykatat e shkallës së parë të Tiranës, Korçës, Vlorës dhe Shkodrës kanë një sportel regjistrimi/informimi në sallën e pritjes. Edhe pse aty shërbejnë dy-tre punonjës të gjykatave, ekziston vetëm një sportel shërbimi, pra, personat mund të shërbehen vetëm me radhë (një nga një). Kjo jo vetëm ngadalëson aksesin në informacion në lidhje me gjykatën, por rezulton edhe në grumbullimin e njerëzve në të njëjtën kohë, gjë që rrit zhurmën dhe mungesën e rregullit në sallën e pritjes.

Gjykatat e shkallës së parë të Durrësit dhe Gjirokastrës nuk kanë sportele informimi, për shkak se hapësira përkatëse është shfrytëzuar për zyra për gjyqtarët, të paktën një sallë gjyqi, një zyrë arkive (e cila shumë shpejt nuk do të mjaftojë për shkak të rritjes së numrit të padive dhe dosjeve gjyqësore) dhe, të paktën, një hapësirë të izoluar për pajisjet e teknologjisë së informacionit. Me emërimin e ndihmësve ligjorë për gjyqtarët administrativë në të gjithë gjykatat, si edhe me emërimin e personelit mbështetës tjetër në disa të tjera, mungesa e hapësirës është bërë çështje shqetësuese.

REKOMANDIMI 4: Të gjitha gjykatat administrative duhet të caktojnë hapësirën për sportelet e informimit. Këto sportele duhet të ideohen në mënyrë të tillë që i gjithë personeli i disponueshëm të japë këshillim.

3.1.5 Përmasat e gjykatave

Gjykatat administrative të shkallës së parë në Durrës, Korçë dhe Shkodër kanë vetëm një kat në dispozicion si për mjedise zyre për gjyqtarët e gjykatave administrative, ashtu edhe për sallën e gjyqit. Pra, seanca zhvillohet ose në të vetmen sallë gjyqi në secilën gjykatë, ose në zyrën e gjyqtarit. Në Korçë dhe Shkodër janë emëruar vetëm dy nga katër gjyqtarët e parashikuar nga LGJA, të cilët koordinohen mes tyre që të përdorin sallën e gjyqit në ditë

specifike të javës apo orë të ditës. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e Vlorës ka dy salla gjyqi për tre gjyqtarë nga katër që parashikohen në LGJA³⁸, të cilët, po ashtu duhet të koordinohen mes tyre për caktimin e orareve të seancave. Shumica e seancave zhvillohen në zyrat e tyre (që ka ndikime në regjistrimin audio dhe pjesëmarrjen e publikut në seanca). Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e Gjirokastrës ka vetëm një sallë gjyqi dhe dy gjyqtarë të emëruar nga katër që parashikohen në Dekretin e Presidentit³⁹ për këtë gjykatë. Dy gjyqtarët administrativë në Gjirokastrë (nga katër që parashikohen nga dekreti i Presidentit për këtë gjykatë) kanë zyrat e tyre. Por, ato janë shumë të vogla për të akomoduar edhe një sekretare(e), palët kundërshtare në gjyq, përfshirë përfaqësimin ligjor të palës joshtetërore dhe, kur është e nevojshme, ekspertin e gjykatës.

REKOMANDIMI 5: Të shihet mundësia për të pasur më shumë salla gjyqi në secilën nga gjykatat e shkallës së parë.

3.1.6 Aksesi fizik në gjykatë dhe lehtësirat për personat me aftësi të kufizuara

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ndodhet në një godinë 4-katëshe të saporinovuar, larg Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.⁴⁰ Godina nuk ka ashensor. Dy hyrjet ndahen nga një gardh dhe mure; një për publikun (palët) dhe tjetra për gjyqtarët dhe punonjësit e gjykatës.

Çdo gjyqtar ka zyrën e vet ku rri edhe sekretaria gjyqësore e caktuar. Me emërimin e tetë ndihmësve ligjorë në këtë gjykatë (dy gjyqtarë ndihmohen nga një ndihmës ligjor), disa hapësirë të gjykatës janë përshtatur si mjedise zyre për të sapoardhurit.

Gjykata nuk është fizikisht e aksesueshme nga personat në karrige me rrota. Rampa në hyrje të godinës mundëson hyrjen deri te salla e pritjes. Kjo pjesë e pritjes sallës është e ndarë me disa shkallë nga pjesa tjetër ku shpallen sallat e seancave, nga banjat dhe nga sallat e gjyqit. Të gjitha sallat e gjyqit ndodhen

38. Neni 4.4 i LGJA

39. Dekret i Presidentit të Republikës, nr.7818, datë 16.11.2012, "Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative".

40. Rreth 3 km larg nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

nëpër katet e gjykatës.

Gjykatat e tjera të shkallës së parë kanë pengesa të ngjashme për aksesin fizik në mjediset e gjykatës. Hyrja në gjykatat administrative të shkallës së parë në Durrës, Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastrë është vetëm me shkallë - nuk ka ashensorë apo rampa. Situata në Korçë është më e mirë, pasi mjediset e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë janë në katin përdhës dhe e vetmja sallë gjyqi ndodhet afër hyrjes kryesore, po në këtë kat. Kjo sallë gjyqi ka hapësirë të bollshme dhe mund të akomodojë personat me nevoja të veçanta.

REKOMANDIMI 6: Në të gjitha sallat e gjyqit ku nuk ka akses për personat me aftësi të kufizuara duhet të bëhen përmirësime. Në rastet kur mendohet të ndryshohet vendndodhja e gjykatave apo të zgjerohet sistemi gjyqësor administrativ aktual, duhet të shihet me prioritet aksesin për personat me aftësi të kufizuara në fazën e planifikimit.

3.1.7 Regjistrimi i seancave

Gjatë muajve qershor dhe korrik 2015, në të gjashta gjykatat administrative të shkallës së parë u instaluan pajisje për regjistrimin e seancave audio dhe pas kësaj gjykatat filluan të regjistrojnë seancat. Më përpara, të gjitha seancat gjyqësore regjistroheshin më shkrim nga sekretaret e gjykatës.⁴¹

Pas korrikut 2015, që të gjitha seancat e mbajtura në salla gjyqi janë regjistruar audio. Megjithatë, shumë seanca vazhduan të mos regjistroheshin audio, siç raportuan vëzhguesit e gjykatave, sepse seancat mbaheshin në zyrat e gjyqtarëve, në të cilat nuk janë instaluar pajisje për regjistrimin audio.

REKOMANDIMI 7: Duhet bërë përpjekje që të mbahen sa më shumë seanca në sallat e gjyqit, në mënyrë që të mund të regjistrohen audio.

41. Për më shumë hollësi referoju Legal Digest of International Fair Trial Rights, OSCE/ODHIR, 2012, Kapitulli IV – E Drejta për një gjykim publik, faqet 77-88 gjendet në <http://www.osce.org/odih/94214?download=true#page=78> [hapur së fundmi më 3 tetor 2016]

3. 2. KOHËZGJATJA E SEANCAVE

3.2.1. Vërejtje të përgjithshme

E drejta e gjykimit brenda një kohe të arsyeshme përbën një garanci të rëndësishme që i mbron të gjitha palët nga vonesat e tepruara procedurale që mund të rrezikojnë si efikasitetin, ashtu edhe besueshmërinë e gjykatave dhe të gjykimit. Neni 6(1) i KEDNJ-së parashikon se *“në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile apo të çfarëdolloj akuze penale, çdokush ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme...”* Ndonëse në standardet ndërkombëtare që përcaktojnë se çfarë do të thotë kohë e arsyeshme nuk ka kritere të përkufizuara, jurisprudenca e GjEDNJ-së ka vendosur disa kritere që duhen marrë parasysh kur vlerësohet nëse vonesat në një rast të caktuar kanë qenë apo jo të arsyeshme, ku përfshihen: (i) kompleksiteti i çështjes; (ii) qëndrimi i shtetit përkatës; (iii) qëndrimi i kërkuarit; (iv) dhe rëndësia e çështjes për kërkuarin.⁴²

3.2.2. Kohëzgjatja e gjyqeve, numri mesatar i seancave dhe vonesat e vëzhguara në gjykatat e shkallës së parë

LGJA garanton parimin e gjykimit brenda një kohe të arsyeshme, duke parashikuar që *“gjykata në një gjykim administrativ siguron që, përmes një procesi të drejtë gjyqësor dhe brenda periudhave kohore të shpejta dhe të arsyeshme, të bëhet mbrojtja ligjore e interesave kushtetuese⁴³ dhe ligjore, të drejtave dhe lirive të subjekteve që mund të shkelen si rrjedhojë e ushtrimit ose mosushtimit të funksioneve publike nga organet e administratës publike.”⁴⁴*

Monitoruesit e gjykatave konstatuan përputhshmëri me nenin 34.2 të Ligjit për Gjykatat Administrative nga gjykatat e shkallës së parë. Gjyqtarët vazhduan rregullisht me seancat në rastet kur palët që ishin njoftuar sipas rregullave nuk paraqiteshin. Kjo praktikë çoi në ulje si të kohëzgjatjes së gjyqeve, ashtu dhe të numrit mesatar të seancave që kërkonte gjykimi i çështjeve.

Monitoruesit e gjykatave panë se gjykatave të shkallës së parë u duheshin

42. Frydlender kundër Francës (kërkesa nr. 30979/96), paragrafi 43; Atanasovic kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë (kërkesa nr. 13886/02), vendimi 22 dhjetor 2005, paragrafi 33; Parizov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë (kërkesa nr. 14258/03), vendimi 7 shkurt 2008, paragrafi 55

43. Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Neni 3 i LGJA

44. Neni 3, pika 1 e LGJA

mesatarisht 2.6 seanca për të mbyllur një çështje, duke përfshirë edhe seancën fillestare dhe seancën e shpalljes së vendimit. Ligji për Gjykatat Administrative ofron hapa të hollësishëm që duhen ndjekur nga gjyqtarët e gjykatave administrative për mbajtjen e një seance përgatitore, një seance kryesore dhe, nëse është nevoja, edhe seancës përfundimtare, ku palët paraqesin kërkesat e tyre të fundit dhe gjykata jep vendimin e shkallës së parë.⁴⁵ Duke marrë parasysh rregullat e reja procedurale dhe rolin aktiv që pritet nga gjyqtarët e gjykatave administrative, gjyqet administrative priten të mbyllen brenda një kohe të arsyeshme në gjykatat administrative të shkallës së parë. Në disa raste, monitoruesit konstatuan se gjyqtarët e shkallës së parë ishin në gjendje të jepnin një vendim të shkallës së parë duke mbajtur vetëm një seancë gjyqësore për të marrë në shqyrtim dokumentet e paraqitura nga secila palë ose nga të dyja palët. Nga ana tjetër, numri më i lartë i seancave gjyqësore u konstatua në Durrës, ku kishte deri në tetë seanca për çështje, pasuar nga Tirana, ku kishte disa raste, ku duheshin deri në shtatë seanca për mbylljen e çështjes. Të gjitha çështjet e paraqitura në tabelën më poshtë janë mbyllur me vendim gjykate brenda gjashtë muajsh.

TABELA NR. 2 MESATARJA E SEANCAVE PËR ÇËSHTJET E PËRFUNDUARA ME VENDIM GJATË VËZHGIMIT

Numri i çështjeve të përfunduara me vendim	Durrës	Gjrokastër	Korçë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	TOTAL
Çështjet	21	28	17	33	20	19	138
Seancat	84	58	49	64	56	49	360
Mesatarja e seancave për çështje	4	2.1	2.9	1.9	2.8	2.6	2.7

3.2.3. Seancat produktive përkundrejt seancave joproduktive në gjykatat e shkallës së parë

Seancat joproduktive shkaktojnë vonesa në gjykim, duke rritur mundësinë e shkeljes së të drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Nga 387 seanca të monitoruara, 42 (ose 10.8%) ishin joproduktive, d.m.th. në to nuk ndodhi asgjë thelbësore sa i përket zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në seancat joproduktive, nuk u dha asnjë argument, nuk u çarkullua asnjë dokument apo material me shkrim, as nuk u mor ndonjë provë dhe as nuk u bë ndonjë kërkesë procedurale.

45. Nenet 25, 27 dhe 34 i LGJA

TABELA NR.3 SEANCAT PRODUKTIVE PËRKUNDREJT ATYRE JOPRODUKTIVE

	Durrës	Gjirokastrë	Korçë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	TOTAL
Numri i seancave	89	62	52	74	61	49	387
Numri i seancave joproductive	14	6	6	9	6	1	42
Përqindje (%)	15,7%	9,7%	11,5%	12,16%	9,83%	2%	10,8%

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë të Vlorës kishte numrin më të vogël të seancave joproductive. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë të Durrësit kishte numrin më të lartë të seancave joproductive.

Një nga arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore në gjykatat e shkallës së parë ishte mosparaqitja e gjyqtarëve ose sekretareve të gjykatave në seancë, pa i informuar palët në mënyrë të përshtatshme dhe në kohën e duhur. Në disa raste, palët, veç e veç ose të dyja së bashku, i kërkuan gjykatës që ta shtynte gjyqin, sepse nuk kishin arritur të përgatiteshin për seancën. Arsyet e dhëna paraqiten në tabelën më poshtë.


TABELA NR.4 ARSYET PËR SHTYRJEN E SEANCAVE GJYQËSORE

Arsyet për shtyrje	Durrës	Gjirokastra	Korça	Shkodra	Tirana	Vlora
Mungesë gjyqtari ose gjyqtari në trajnim	6	1	5	1	2	0
Mungesë e sekretarit/es gjyqësor/e	0	0	0	0	1	0
Mos formim i trupit gjykues	0	0	1	0	0	0
Mos njoftim i palëve	0	1	0	1	1	1
Mos dorëzim raporti nga eksperti	3	1	0	2	1	0
Gjyqtari nuk ka studiuar dosjen	0	0	0	1	0	0
Kërkesë nga avokati për të shqyrtuar dosjen	2	1	0	0	0	0
Pala shtet nuk sollti dokumentet e kërkuara	0	0	0	1	1	0
Mungesë avokati	3	2	0	3	0	0

Sipas Ligjit për Gjykatat Administrative, gjykata është përgjegjëse për të garantuar që ekspertët ta japin mendimin e tyre në kohën e duhur⁴⁶, duke mos u lejuar më shumë se 20 ditë për prodhimin e një raporti.⁴⁷ Monitoruesit konstatuan se kishte vonesa në disa raste, ku nuk ishte paraqitur raporti i ekspertit në gjykatë në kohën e duhur. Në 85% të rasteve, kur ishte kërkuar mendimi i ekspertëve, ata e paraqitën raportin e tyre pasi kishte kaluar afati.

GRAFIKU NR. 1 RESPEKTIMI I AFATEVE PËR PARAQITJEN E RAPORTEVE NGA EKSPERTËT

 A e paraqiti eksperti raportin para afatit të caktuar nga gjykata?



REKOMANDIMI 8: Duhet të përmirësohet bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për t'u siguruar që seancat të mos planifikohen në datat kur gjyqtarët janë në trajnim.

REKOMANDIMI 9: Gjyqtarët duhet të ndërtojnë një dialog me dhomën lokale të avokatisë për të inkurajuar pjesëmarrjen e tyre në seancat gjyqësore.

46. Wohlmeyer Bau GmbH kundër Austrisë (kërkesa nr. 20077/02), vendimi 8 korrik 2004, paragrafi 52; Capuano kundër Italisë (kërkesa nr. 9381/81), vendimi 19 maj 1987, paragrafi 32; Peryt kundër Polonisë (kërkesa nr. 42042/98), vendimi 2 dhjetor 203, paragrafi 57

47. Neni 25 i LGJA

3.2.4. Shqyrtimi i çështjeve nga Gjykata Administrative e Apelit

Gjykata Administrative e Apelit i zhvillon si rregull gjykimet mbi bazë dokumentesh, duke u mbështetur në përmbajtjen e dosjeve të ardhura për gjykim nga gjykatat administrative të shkallës së parë, sipas dispozitave përkatëse të LGJA.⁴⁸ Kjo është e mundur në rastet kur Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se dosja e ardhur nga gjykata administrative e shkallës së parë përmban të dhëna të mjaftueshme që bëjnë të mundur përcaktimin e shkaqeve të ngritura në ankim. Nëse nuk jemi para këtij rasti, Gjykata Administrative e Apelit thërret palët për të qenë të pranishme në seancë gjyqësore. Kjo seancë është publike dhe zhvillohet në mnëryrë të ngjashme me seancën gjyqësore në shkallë të parë.

Ndërkohë që në gjykatat e shkallës së parë përdoret sistemi manual i hedhjes së shortit, në Gjykatën Administrative të Apelit vihet në përdorim sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve (ICMIS). Nga muaji qershor 2015 paisjet e regjistrimit audio janë në funksionim. Tabela në vijim paraqet të dhëna mbi ankimet e çështjeve të ardhura nga të gjashtë gjykatat e shkallës së parë.

TABELA NR.5 ANKIMET PËR ÇËSHTJET E VËZHGUARA

	Tiranë	Durrës	Gjirokastrë	Korçë	Shkodër	Vlorë	TOTAL
Çështje të vëzhguara	23	22	32	20	43	19	159
Çështje me vendim përfundimtar të shkallës së parë ⁴⁹	20	21	28	17	33	19	138
Çështje të ankimuara ⁵⁰	8	14	23	9	19	12	85
Çështje të gjykuara në Apel	1 ⁵¹	0	0	1 ⁵²	0	1 ⁵³	3 ⁵⁴

48. Neni 49, pika 1 e LGJA parashikon: "1. Shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit."

49. Për çështjet e vëzhguara nga 1 maj 2015 deri në 30 nëntor 2015

50. Bazuar në raportimin mujor të vëzhguesve pranë Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë në Durrës, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë, Shkodër dhe Tiranë

51. Gjykata e Apelit Administrativ Ia në fuqi pjesërisht vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

52. Gjykata e Apelit Administrativ Ia në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

53. Gjykata e Apelit Administrativ Ia në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Data e vendimit është 2 mars 2016, që është tre muaj pas periudhës së parashikuar për veprimtarinë vëzhguese në projekt.

54. Bazuar në të dhënat e grumbulluara në 2016, ndërsa periudha e vëzhgimit e parashikuar në projekt ishte përcaktuar nga 1 maji deri në 30 nëntor 2015.

Ndryshe nga efikasiteti i konsiderueshëm me të cilin rezulton të jenë shqyrtuar çështjet në gjykatat e shkallës së parë, në apel u evidentuan probleme thelbësore. Nga 138 vendime përfundimtare të dhëna nga gjykatat administrative të shkallës së parë, 85 të tilla u ankimuan.⁵⁵

Më tej, Gjykata e Apelit përfundoi vetëm tri nga këto çështje gjatë periudhës së vëzhgimit. Vëzhguesi pranë Gjykatës Administrative të Apelit vuri re mosrespektimin e afatit 30 ditor të shqyrtimit të çështjes në apel. Kjo përbën shkelje të nenit 48, pika 2 të LGJA i cili përcakton se "Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi".

Për të evidentuar shkaqet e këtyre vonesave në shqyrtimin e çështjeve, vëzhguesi zhvilloi disa takime me Kryetarin e Gjykatës së Apelit, me gjyqtarë dhe sekretare gjyqësore. Nga këto takime, shkaqet kryesore që çonin në mosrespektimin e afateve të parashikuara për shqyrtimin e çështjes, rezultuan të ishin ngarkesa e tepër dhe numri i papërshtatshëm i gjyqtarëve dhe i ndihmësve ligjorë. Numri i gjyqtarëve në këtë gjykatë gjatë periudhës së monitoruar ishte vetëm shtatë, ndërkohë që ndihmësat ligjorë filluan punë pranë gjyqtarëve të gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të apelit në muajin qershor 2015. Dhjetë ndihmës ligjorë u emëruan pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Në fillim të vitit 2015, Këshilli i Lartë të Drjetësisë miratoi një raport vlerësues mbi ngarkesën e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit për periudhën janar-shtator 2014. Raporti përmban të dhëna mbi numrin e çështjeve të caktuara gjyqtarëve në gjykatat civile të apelit dhe gjykatave administrative.⁵⁶ Sipas raportit, një gjyqtar në gjykatën civile të apelit kishte shqyrtuar mesatarisht 125 çështje në nëntë muaj nga një mesatare prej 440 çështjesh që i ishin caktuar. Për të njëjtën periudhë, një gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit kishte shqyrtuar një mesatare prej 513 çështjesh prej një mesatareje prej 1650 çështjesh të caktuara. Duket qartë, se mesatarisht,

55. Duhet sqaruar se 138 çështje nga 159 të përzgjedhura për vëzhgim u përfunduan me një vendim përfundimtar nga gjykatat administrative të shkallës së parë, kurse 21 të tjera vijuan përtej kësaj periudhe kohe.

56. Studim vlerësues mbi ngarkesën e punës në Gjykatën Administrative të Apelit [Assessment study on the workload of the Administrative Court of Appeal], fq. 37, gjendet në <http://kld.al/korniza-ligjore/akte-nenligjore/studimi-mbi-ngarkesen-ne-gjykatën-administrative-te-apelit>, [hapur së fundmi më 18 tetor 2016]

një gjyqtar i apelit administrativ kishte marrë dhe kishte shqyrtuar katër herë më shumë çështje sesa një gjyqtar i gjykatës civile të apelit.

Sipas Raportit Vjetor të Gjykatës Administrative të Apelit për vitin 2015, i cili mbulon periudhën janar-dhjetor 2015, numri vjetor mesatar i çështjeve të shqyrtuara nga një gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit ishte 431⁵⁷, në harkun nga 315 në 1268 çështje për gjyqtar.⁵⁸ Edhe pse shqyrtimi dhe vendimmarrja gjatë shqyrtimit të ankimeve në apel është e ndryshme nga ajo në gjykatën administrative të apelit, këto të dhëna statistikore tregojnë shpejtësinë e konsiderueshme me të cilën kanë shqyrtuar paditë administrative, si dhe numrin e lartë të çështjeve i cili i caktohet për gjykim gjyqtarëve administrativë. Kështu, problemi nuk qëndron tek shpejtësia e gjykimit, por tek ngarkesa e çdo gjyqtari.

Numri i ulët i çështjeve të monitoruara në Gjykatën Administrative të Apelit krahasuar me numrim e lartë të çështjeve të përfunduara nga kjo gjykatë, nuk mundëson nxjerrjen e përfundimeve mbi vendimmarrjen nga gjykatat administrative të shkallës së parë.

Krahas problematikës së numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve, shqetësues mbetet mekanizmi/procedura si dhe burimet e kufizuara financiare dhe njerëzore të gjykatave të shkallës së parë në transferimin e çështjeve nga shkalla e parë në Gjykatën Administrative të Apelit në Tiranë. Aktualisht, dosjet gjyqësore transferohen fizikisht, veprim ky që sjell vonesa të tepërta, kryesisht për shkak të largësisë së disa prej gjykatave të shkallës së parë. Gjykatat e Gjirokastrës dhe Korçës janë posaçërisht larg nga Tirana.

Mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore nuk përbën një shkak të arsyeshëm për vonesa në zgjidhjen e çështjeve sipas së drejtës ndërkombëtare. Shteti ka detyrimin pozitiv që të sigurojë përputhje me standartet ndërkombëtare, përfshirë ndërmarrjen e nismave ligjore si dhe caktimin e burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të mundësuar shqyrtimin e çështjeve. Ngarkesa e paparashikuar dhe numri i kufizuar i gjyqtarëve dhe i stafit ndihmës mund të justifikojë vonesa vetëm nëse këto rrethana janë të jashtëzakonshme, të përkohshme, dhe nuk vijnë nga probleme institucionale. Në këto raste, masa – të tilla si emërimi i

57. Analiza e punës të Gjykatës të Apelit Administrativ për vitin 2015, fq.1, gjendet në http://www.gjykataadministrativeapelit.al/?page_id=436, [hapur së fundmi më 20 shtator 2016]

58. Po aty

gjyqtarëve të tjerë apo i personelit administrativ shtesë – duhen marrë sa më shpejt për të zgjidhur këtë problem. Vonesat që vijnë nga ngarkesat afatgjata në funksionimin e sistemi të gjykatave, së bashku me mungesën e marrjes së masave përkatëse nga shteti, janë konsideruar si shkelje të KEDNJ-së.⁵⁹

REKOMANDIM 10: Nëse Gjykata Administrative e Apelit do të vazhdojë të funksionojë si gjykata e vetme administrative për të gjithë vendin, Prezenca rekomandon që numri i personelit të gjykatës, përfshirë gjyqtarët, ndihmësit ligjorë dhe personelin mbështetës të rritet. Në mënyrë alternative, dhe si një perspektivë më e preferuar për Prezencën, legjislativi dhe ekzekutivi në Shqipëri të vlerësojë rritjen e numrit të gjykatave administrative në vend. Duke qenë se Reforma në Drejtësi është në proces, ky mund të jetë çasti i duhur për ta marrë në konsideratë zgjidhjen e kësaj çështjeje.

REKOMANDIM 11: Të merret në konsideratë transferimi elektronik i dosjeve. Në mënyrë alternative, të rishihet funksionaliteti i sistemit fizik të transferimit me qëllim rritjen e efikasitetit të tij.

3.3. BARAZIA E ARMËVE, PARAQITJA E PROVAVEN DHE PËRFAQËSIMI LIGJOR

3.3.1. Vëzhgime të përgjithshme

Barazia e armëve është një element përbërës i rëndësishëm i të drejtës për një gjykim të paanshëm të parashikuar në Nenin 6 të KEDNJ-së. Ky parim garanton cilindo që është palë në një proces për të patur një mundësi të arsyeshme për të paraqitur çështjen e vet para gjykatës në kushte që nuk e vendosin para ndonjë disavantazhi thelbësor përkundëjt palës tjetër kundërshtarë.⁶⁰

Paanësia procedurale kërkon që secila palë të ketë një mundësi të drejtë për

59. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Drejt Drejtësisë – Analizë e Procesit Civil në gjykatat e rretheve gjyqësore, fq. 25, Tiranë, 2012, gjendet në [http://www.osce.org/resources/publications?filters=im_taxonomy_vid_1:\(6\)](http://www.osce.org/resources/publications?filters=im_taxonomy_vid_1:(6)) [hapur së fundmi më 27 shtator 2016]

60. Werner kundër Austrisë [1997] GJEDNJ 92, paragrafi 63; Coëme dhe të Tjerë kundër Belgjikës [2000] GJEDNJ 250, paragrafi 102; G.B.kundër Francës GJEDNJ 564, paragrafi 58, cituar nga Legal Digest of International Fair Trial Standards, botim i OSBE/ ODIHR-it, 2012

të paraqitur çështjen e vet para gjykatës dhe për të kundërshtuar rastin e palës ndërgjyqëse në një periudhë kohe të përshtatshme dhe në një mënyrë të vlefshme.

Për të përcaktuar nëse parimi i barazisë së palëve është respektuar ose jo gjatë procesit gjyqësor, vëzhguesit janë përqendruar në mundësinë reale të palëve për të ushtruar të drejtat e tyre procedurale duke përfshirë këtu mundësinë për të paraqitur kërkesa dhe prova, apo nëse pala kundërshtare ishte njoftuar dhe i ishte lënë kohë mjaftueshëm për të bërë parashtresat e veta, në zotërimin dhe aksesin në dokumente dhe informacion në lidhje me çështjen për të gjitha palët, në ndjekjen e procedurës për të garantuar ekuilibrin midis palëve dhe pasjen e ndihmës ligjore për të lehtësuar pjesëmarrjen aktive të personave privatë në gjykimet administrative.

3.3.2. Detyrimi i gjykatës për të vendosur masa ndëshkuese për mos paraqitjen e provave nga organi publik


Neni 26 i LGJA parashikon që palët të paraqesin provat para gjykatës para seancës së parë. Nëse një organ publik nuk i paraqet provat pa patur ndonjë arsye të përshtatshme, atëherë i njëjti nen parashikon se gjykata mund të vendosë gjobë për titullarin e organit publik.⁶¹ Qëllimi i këtij neni është që të forcojë pozitën vulnerabel të individëve përballë institucioneve shtetërore, që në përgjithësi kanë më shumë burime njerëzore dhe kapacitete materiale. Megjithatë, vëzhguesit vërejtën se gjykatat nuk vendosin masa ndëshkuese ndaj palës apo pjesëmarrësve në gjykim në gati 99 % të çështjeve të monitoruara. Nëse gjykata do të vendosni masa ndëshkuese ndaj palëve që nuk paraqitën prova në afatin e vendosur nga gjykata, ka gjasa që numri i seancave joproduktive që lidhen me mosveprimin e palëve do të ishte më i ulët.⁶²

61. Neni 26.2 i LGJA parashikon se një shkelje e pajustificuar e detyrimit për të paraqitur provave nga ana e organit publik edhe pas një afati të dytë kohor përbën shkak që gjykata me kërkesë të palës apo me iniciativën e vet të vendosë gjobë ndaj titullarit të organit publik. Masa e gjobës është e barabartë me 20% të pagës minimale në shkallë vendi, për çdo ditë vonesë.

62. Shih Tabelën nr.4

GRAFIKU NR. 2 VENDOSJA E MASAVE NDËSHKUESE NËSE PALËT NUK ZBATOJNË URDHËRAT E GJYKATËS PËR PARAQITJEN E PROVAVE

A vendosi gjykata masa ndërkimore ndaj pjesëmarrësve në gjykim që nuk kryen detyrat e kërkuara?



REKOMANDIM 12: Gjyqtarët duhet t'i ndërgjegjësojnë palët në gjykim se do të vendosin masa ndëshkuese ndaj atyre që nuk i zbatojnë kërkesat e gjykatës në afatin e caktuar prej gjykatës në rastet kur LGJA e parashikon këtë.

3.3.3. Dëshmia e palëve dhe dëshmitarëve

Sipas LGJA gjykimet administrative bazohen në dokumente shkresore, megjithatë palët mund të kërkojnë që të paraqesin shpjegime me gojë.⁶³

Dëshmia përfshihet në radhën e provave që gjykata mund të marrë në konsideratë për të arritur në një vendim në lidhje me çështjen.⁶⁴

Rezultatet e monitorimit tregojnë se proceset administrative janë kryesisht të bazuara në provat shkresore. Vëzhguesit e gjykatave raportojnë se palët kanë dëshmuar në vetëm 18 % të çështjeve, ndërsa dëshmitarët në vetëm 1% të tyre.⁶⁵


63. Neni 34, pika 3 e LGJA

64. Nenet 21, 25 dhe 27 të LGJA

65. Deklarimet me dëshmitarë janë vërejtuar në raste të kufizuara (nga një rast) në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, Gjirokastër dhe Korçë


GRAFIKU NR. 3 DËSHMITË E PALËVE NË GJYKIMET ADMINISTRATIVE

A dëshmoi ndonjë palë gjatë gjykimit?



GRAFIKU NR. 4 DEKLARIMET E DËSHMITARËVE NË GJYKIMET ADMINISTRATIVE

A dëshmoi ndonjë dëshmitar në seancë?




3.3.4. Roli i gjyqtarëve për të informuar palët mbi historikun procedural, përfqësimin ligjor dhe të drejtën për ndihmë ligjore pa pagesë

Grupi i vëzhguesve të gjykatave raportojnë se në mjaft seanca (44%), gjyqtarët i kanë informuar palët mbi elementet thelbësore të mosmarrëveshjes konkrete dhe në 14% të çështjeve edhe për historikun procedural të tyre.

Grafiku në vijim paraqet përqindjen e seancave (pa përfshirë këtu ato paraprake) rastet kur gjyqtarët e nisin seancën me një përmbledhje të historikut procedural të çështjes.

GRAFIKU NR.5 SHPJEGIMI I HISTORIKUT PROCEDURAL TË ÇËSHTJES NGA GJYQTARËT NË FILLIM TË SEANCËS

 A paraqiti gjyqtari të dhëna mbi historikun procedural?



Megjithëse nuk ka ndonjë detyrim ligjor në LGJA për gjyqtarin administrativ që të paraqesë një përmbledhje të seancës së mëparshme gjyqësore, kjo do t'i ndihmonte palët dhe do të rriste eficiencën, veçanërisht kur palët nuk kanë shfaqur vëmendjen e duhur në seancat e mëparshme.


REKOMANDIM 13: Gjyqtarët shkurtimisht duhet të paraqesin historikun procedural në fillim të çdo seance gjyqësore që nuk është seanca paraprake.

3.3.4.1. Përfaqësimi ligjor i palëve dhe ndihma ligjore falas

LGJA nuk i detyron palët që të kenë përfaqësim ligjor gjatë gjykimit administrativ. Palët në mënyrë të pavarur mund të vendosin nëse do të kërkojnë ndihmë ligjore dhe LGJA nuk e përfshin detyrimisht atë.

GRAFIKU NR.6 PËRFAQËSIMI LIGJOR

 A është pala e përfaqësuar?



Mundësia për ndihmë ligjore parashikohet në Ligjin për Ndhimë Juridike (LNJ) që parashikon se cilët mund të jenë përfituesit nga kjo ndihmë, kushtet dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike falas.⁶⁶ LGJA nuk referon në mënyrë të shprehur tek kjo mundësi ligjore.

Referimi i munguar në LGJA për tek LNJ shkakton një gjendje të paafavorshme për të drejtën e të qenit i përfaqësuar para gjykatave administrative.

REKOMANDIM 14: LGJA duhet të ketë një referim tek LNJ dhe të parashikojë se gjyqtarët duhet të informojnë palët që mund të mund të plotësojnë kushtet për ndihmë juridike falas.

66. Neni 13 i Ligjit për Ndhimën Juridike, nr.10039, datë 22 dhjetor 2008, ndryshuar me Ligjin nr.77/2014

3.4 CAKTIMI I ÇËSHTJEVE

Procedura për caktimin e çështjeve është përcaktuar me Vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,⁶⁷ e cila parashikon se çështjet duhet t'ju caktohen gjyqtarëve në bazë të procedurës me short elektronik. Gjykatat administrative të shkallës së parë kanë ndjekur procedurën e shortit manual për caktimin e çështjeve. Sipas kësaj procedure kërkohet që kancelari i gjykatës, një sekretare dhe gjyqtarët të jenë të pranishëm gjatë ndarjes me short të çështjeve, të cilat sipas numrit të regjistrimit tërhiqen me short nga një vazo dhe më pas u bashkëngjiten emrat e gjyqtarëve të tëhequr në mënyrë rastësore anonime nga një vazo tjetër. Kjo procedurë mbahet shënim nga sekretaria e gjykatës dhe nga kjo datë nis afati procedural për hapat e çështjes konkrete të caktuar një gjyqtari. Mundësitë për manipulim janë më të larta në këtë lloj procesi të caktimit të çështjeve dhe ky proces është më pak eficient sesa sistemi elektronik.

REKOMANDIM 15: Gjykatat administrative të shkallës së parë duhet të pajisen me mjetet e nevojshme për t'ju mundësuar atyre caktimin elektronik të çështjeve tek gjyqtarët.

67. Vendimi nr.238/1/ai Këshillit të Lartë të Drejtësisë, 2008 "Mbi procedurën e shortit për caktimin e çështjeve", i ndryshuar

KAPITULLI

4

Përfundime dhe rekomandime

Sikundër është shtjelluar më lart në këtë raport, ligji i ri për gjykatat administrative ka themeluar jo vetëm një sistem të ri të gjykatave administrative, por ka prezantuar risi procedurale që synojnë të rrisin eficiencën e proceseve administrative dhe që mbrojnë të drejtat e gjykimit të paanshëm të palëve, veçanërisht ato të qytetarëve.

Vëzhguesit kanë vërejtur praktika të mira në gjykatat e shkallës së parë, të cilat, përgjithësisht i kanë gjykuar çështjet pa vonesë. Gjyqtarët

Gjyqtarët iu janë drejtuar parashikimeve të LGJA për të korrigjuar pabarazinë e armëve midis shtetit dhe palëve private dhe për të garantuar që çështjet të gjykohen duke eliminuar shtyrjet e panevojshme. Megjithatë, gjyqtarët kanë vendosur masa ndëshkuese me gjobë në raste të rralla. Duke rritur ndërgjegjësimin e palëve mbi mundësinë ligjore për vendosjen e masave ndëshkuese në rast se palët nuk i plotësojnë detyrimet e tyre ndaj gjykatës, gjyqtarët mund të ndihmojnë në rritjen e mëtejshme të eficiencës së gjykimeve. Gjithashtu, një bashkërendim më i mirë i punës me pjesëmarrësit në gjykim dhe aktorë të tjerë të drejtësisë administrative, duke përfshirë këtu avokatët dhe Shkollën e Magjistraturës mund të çojë në uljen e numrit të seancave të shtyra për shkak të mospjesëmarrjes së palëve.

Arsyet që kanë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjeve në Gjykatën e Apelit Administrativ përbëjnë një shqetësim të madh. Numri mjaft i lartë i çështjeve që presin të gjykohen, që vjen si rrjedhojë e mungesës së numrit të nevojshëm të gjyqtarëve dhe personelit të nevojshëm të gjykatës, nuk përbën justifikim për mospërputhje me standardet ndërkombëtare të gjykimit të drejtë përsa i takon gjykimit të çështjeve administrative brenda afateve të arsyeshme. Në lidhje me këtë çështje janë paraqitur disa rekomandime për të rregulluar gjendjen.

Burime të pamjaftueshme njerëzore dhe materiale dhe infrastruktura e paplotë shfaqen si çështje problematike në të gjitha gjykata, duke shkaktuar problem për aksesin në drejtësi. Rekomandimet e Prezencës lidhen me përpjekjet për

të zgjidhur çështjet e aksesit të personave me aftësi të kufizuara, mungesën e sallave të gjyqit, mangësive lidhur me zyrat e informacionit, mungesën e ofrimit të informacionit online dhe mungesën e sistemit për caktimin e çështjeve me short elektronik.

Pavarësisht se nga monitorimi rezulton se shumica e paditësve kanë qenë të përfaqësuar ligjërisht, Prezenca vëren një numër të vogël paditësish që mund të kishin nevojë dhe duhej të ishin udhëzuar për të parë mundësinë e përfitimit të ndihmës ligjore falas dhe për këtë arsye paraqitet si rekomandim marrja e masave për të çuar më tej ndërgjegjësimin e publikut për këtë mundësi ligjore.

Së fundi, ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga gjykata është një pjesë përbërëse integrale e gjykimit të drejtë. Për fat të keq, për shkak të numrit të kufizuara të çështjeve të apeluara gjatë periudhës së monitorimit nuk ka qenë e mundur të vëzhgohet ekzekutimi i ndonjë vendimi të gjykatave administrative.

Prezenca rekomandon që trajtimi i çështjeve që apelohehen dhe ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë të jenë në vëmendje të vëzhgimeve të ardhshme në fushën e gjykimeve administrative.

REKOMANDIME:

REKOMANDIMI 1: Duhet të rishikohet mbulimi gjeografik i secilës gjykatës të shkallës së parë dhe të shihet mundësia për ngritjen e degëve ose gjykatave “udhëtuese” për zonat e largëta.

REKOMANDIMI 2: Të gjitha gjykatat administrative duhet të respektojnë një nivel të njëjtë transparence dhe të lehtësojnë aksesin e publikut në gjykata, duke shpallur një variant të standardizuar të kalendarit të seancave (përfshirë edhe vendin/sallën e seancës, ku është e mundur) në stendat informuese dhe në faqen e internetit të gjykatës (nëse ka), çdo javë. Duhet të hartohet një rregullore e brendshme që të gjitha gjykatat administrative të përdorin një kalendar javor të standardizuar.

REKOMANDIMI 3: Të gjitha gjykatat administrative duhet të kenë faqen e

internetit të tyre ose një të përbashkët, ku të jepet informacion i përditësuar dhe i aksesueshëm, përfshirë kalendarin javor të gjykatës.

REKOMANDIMI 4: Të gjitha gjykatat administrative duhet të caktojnë hapësirën për sportelet e informimit. Këto sportele duhet të ideohen në mënyrë të tillë që i gjithë personeli i disponueshëm të japë këshillim.

REKOMANDIMI 5: Të shihet mundësia për të pasur më shumë salla gjyqi në secilën nga gjykatat e shkallës së parë.

REKOMANDIMI 6: Në të gjitha sallat e gjyqit ku nuk ka akses për personat me aftësi të kufizuara duhet të bëhen përmirësime. Në rastet kur mendohet të ndryshohet vendndodhja e gjykatave apo të zgjerohet sistemi administrativ aktual, duhet të shihet me prioritet aksesit për personat me aftësi të kufizuara në fazën e planifikimit.

REKOMANDIMI 7: Duhet të bëhet përpjekje që të mbahen sa më shumë seanca në sallat e gjyqit, në mënyrë që të mund të regjistrohen audio.

REKOMANDIMI 8: Duhet të përmirësohet bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për t'u siguruar që seancat të mos planifikohen në datat kur gjyqtarët janë në trajnim.

REKOMANDIMI 9: Gjyqtarët duhet të ndërtojnë një dialog me dhomën lokale të avokatisë për të inkurajuar pjesëmarrjen e tyre në seancat gjyqësore.

REKOMANDIMI 10: Nëse Gjykata Administrative e Apelit do të vazhdojë të funksionojë si gjykata e vetme administrative për të gjithë vendin, Prezenca rekomandon që numri i personelit të gjykatës, përfshirë gjyqtarët, ndihmësit ligjorë dhe personelin mbështetës të rritet. Në mënyrë alternative, dhe si një perspektivë më e preferuar për Prezencën, legjislativi dhe ekzekutivi në Shqipëri të vlerësojë rritjen e numrit të gjykatave administrative në vend. Duke qenë se Reforma në Drejtësi është në proces, ky mund të jetë çasti i duhur për ta marrë në konsideratë zgjidhjen e kësaj çështjeje.

REKOMANDIMI 11: Të merret në konsideratë transferimi elektronik i dosjeve. Në mënyrë alternative, të rishihet funksionaliteti i sistemit fizik të transferimit me qëllim rritjen e efikasitetit të tij.

REKOMANDIM 12: Në rastet kur ka mbingarkesë çëshjesh, mund të ndërmerren masa të tilla të shpejta si caktim gjyqtarësh shtesë, apo edhe punonjës shtesë ndihmës për të zgjidhur gjendjen e vështirë të krijuar.

REKOMANDIM 13: Gjyqtarët duhet t'i ndërgjegjësojnë palët në gjykim se do të vendosin masa ndëshkuese ndaj atyre që nuk i zbatojnë kërkesat e gjykatës në afatin e caktuar prej gjykatës në rastet kur LGJA e parashikon këtë.

REKOMANDIM 14: Gjyqtarët shkurtimisht duhet të paraqesin historikun procedural në fillim të çdo seance gjyqësore që nuk është seancë paraprake.

REKOMANDIM 15: LGJA duhet të ketë një referim tek LNJ dhe të parashikojë se gjyqtarët duhet të informojnë palët që mund të mund të plotësojnë kushtet për ndihmë juridike falas.

REKOMANDIM 16: Gjykatat administrative të shkallës së parë duhet të pajisen me aparaturat e përshtatshme që mundësojnë caktimin elektronik të çështjeve tek gjyqtarët.

REKOMANDIM 17: Në kohën e përgatitjes së propozimeve për buxhetin e vitit të ardhshëm kalendarik, gjykatat administrative duhet të kërkojnë t'ju garantohen burime të mjaftueshme financiare për të zgjidhur shkaqet që shkaktojnë vonesa, sikundër janë mungesa e personelit të gjykatës apo e pajisjeve.

REKOMANDIM 18: Prezenca mori të dhëna për 3 çështje që u apeluar nga shkalla e parë dhe u gjykuan nga Gjykata e Apelit Administrativ, sipas afateve të veprimtarisë vëzhguese. Prandaj, monitorimi i fazës së apelit dhe i ekzekutimit duhet të vijojë gjatë vitit 2017 për të gjykuar eficiencën e tyre dhe për të arritur në përfundime dhe rekomandime të vlefshme.

Shtojcë–FORMULARI I MONITORIMIT TË GJYKIMIT ADMINISTRATIV (varianti në dokument word i formularit elektronik të përgatitur nga Prezenca)

1. TË DHËNA ADMINISTRATIVE	
Emri i plotë i vëzhguesit:	
Data e vëzhgimit:	
Ora e fillimit të vëzhgimit:	
Ora e mbarimit të vëzhgimit:	
2. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI ÇËSHTJEN	
2.1 IDENTIFIKIMI I ÇËSHTJES	
Gjykata:	m Tirana m Gjykata e Apelit m Korca m Durrës m Vlora m Shkodra m Gjirokastra
Numri i çështjes:	
Emri i çështjes:	
Data e regjistrimit fillestar ⁶⁸ :	
Statusi i çështjes dhe monitorimi i mëparshëm i saj ⁶⁹ :	A u gjykua kjo çështje vetëm në një seancë? Po (Kaloni tek seksioni 2.2) m Jo A ishte kjo seanca e parë m Po (Kaloni tek seksioni 2.2) m Jo Nëse kjo nuk ishte seanca e parë, a keni ndjekur një ose disa seanca të mëparshme të kësaj çështjeje? m Po m Jo Nëse kjo ishte seanca përfundimtare e kësaj çështjeje, a i keni monitoruar të gjitha seancat e saj? m Po m Jo
2.2 HOLLËSI TË MOSMARRËVESHJES ⁷⁰	
Kush e ka paraqitur çështjen?	m Një qytetar (individ) m Një person juridik jo shtetëror (shoqëri tregtare, organizatë, aleancë etj.) m Administrata

68. Nëse është rast apelimi, ju lutemi tregoni datën në të cilën është regjistruar ankimi në nivelin e apelit. Informacioni përkatës për sa i takon shkallës së parë duhet të jepet në Seksionin 2.2.1, "Gjykimi në apel".

69. Është me rëndësi që vëzhguesi të sigurohet se informacioni i përmbledhur në këtë seksion është i saktë. Ky informacion do t'i mundësojë Menaxherit të Projektit të grupojë seancat sipas çështjes dhe të mbledhë të dhëna statistikore mbi numrin e seancave të nevojshme për të gjykuar një çështje.

70. Nëse ka disa seanca të monitoruara për të njëjtën çështje, ky seksion nuk ka gjasa të ndryshojë nga një seancë tek tjetra. Kështu që, vëzhguesi, në varësi të preferencës së vet, mund ta kopjojë informacionin e marrë në seancën e mëparshme për këtë çështje. Nëse, ka patur ndryshime (ndryshimi i objektit të padisë, përbërja e trupit gjykues, faktet, etj.) është me rëndësi që këto ndryshime të reflektohen nga vëzhguesi në formular.

<p>Natyra e mosmarrëveshjes:</p>	<p>m Marrëdhënie pune në administratën publike m mosmarrëveshje lidhur me pensionet m Taksa apo tarifa doganore m (mos) regjistrim prone</p> <p>m Leje dhe licenca m Të tjera, ju lutemi përcaktojini:</p>
<p>Hollësi mbi mosmarrëveshjen për marrëdhënie pune</p> <p>Ky seksion duhet të plotësohet vetëm nëse mosmarrëveshja lidhet me marrëdhëniet e punës në administratën publike.</p>	<p>Natyra e mosmarrëveshjes së punësimit: m Mospagim rroge (sasia e pretenduar: _____) m Mos pagim i ndonjë shume të ndonjë lloji tjetër → Lloji i shumës së parave të kërkuara: Sasia: m Ulje në detyrë m Largim nga puna m Transferim pa pëlqim m Të tjera, ju lutemi përcaktojini: Lloji i punëdhësit: m Administratë qendrore m Administratë vendore m Institucion i pavarur Kategoria e marrëdhënies së punës m Nëpunës civil m jo nëpunës civil Cili është/ishte titulli i pozicionit të punës?: – A është akoma në marrëdhënie pune në atë institucion? m Yes - Po m No - Jo</p>
<p>Shkaku për padinë (baza ligjore dhe neni/et)⁷¹:</p>	
<p>Faktet elementare/ përmbledhja e padisë Ju lutemi, paraqesni një përmbledhje të fakteve të çështjes:</p>	
<p>Procesi administrative para paraqitjes së kërkesë padisë: Nëse është e mundur, paraqesni çfarë ka ndodhur në nivelin administrative para se të bëhej kërkesë padia (nëse ka patur ndonjë proces kontrolli të brendshëm në administratë, duke përfshirë edhe datat).</p>	
<p>Historiku elementar procedural në nivel gjyqësor: Ju lutemi, paraqesni një përmbledhje të historikut elementar procedural të çështjes. Për shembull, shënoni seancat e mëparshme, duke përfshirë datat e tyre. Nëse çështja monitorohet në nivel apeli, paraqesni një përmbledhje të shkurtër të historikut procedural para se të regjistrohej çështja në apel.</p>	

71. Nëse është e mundur tregoni bazën ligjore dhe mbi cilat nene bazohet kërkesë padia.

Ndryshime të palëve apo përfaqësuesve të tyre:	A ka patur ndonjë ndryshim tek palët apo tek përfaqësuesit ligjorë gjatë gjyqimit/ midis seancave të ndryshme? m Po m Jo → Ju lutemi, paraqisni hollësi (kush, kur, pse?):
Nëse palë të tjera janë përfshirë apo nëse do të shtonit ndonjë informacion tjetër mbi palët e përshkuara më lart, ju lutemi përdorni këtë hapësirë.	
3. INFORMACION MBI SEANCËN⁷²	
Data e seancës:	
Lloji i seancës:	m Seancë përgatitore m seancë dëgjimore (e rregullt) m Seancë për vendim
Sekretarja e seancës:	Emri i plotë: Gjinia: m M m F
3.1 PALËT DHE PËRFAQËSUESIT	
⁷³ A ishin të gjitha palët të pranishme në këtë seancë?	m Po m Jo
A kishte ndonjë nga palët përfaqësuesin e vet në mungesë dhe që nuk u zëvendësua?	m Po m Jo → Ju lutemi, shpjegoni kush mungonte dhe pse:
A kërkoi ndonjë nga palët përfaqësues/ avokat, por nuk kishte?	m Po m Jo → Please explain the underlying circumstances: Ju lutemi, shpjegoni rrethanat:
A i dha gjyqtari informacion mbi ndihmën ligjore palës pa përfaqësues?	m Nuk zbatohet. m Po m Jo
Komente lidhur me qëndrimin dhe paraqitjen e avokatit (nëse është e mundur)	
3.2 SEANCA PUBLIKE DHE QASJA NË GJYKATË	
Ku u zhvilluar seanca?	m Në sallë gjyqi. → Kapaciteti i sallës së gjyqit: m Në zyrën e gjyqtarit. → Arsyet për zhvillimin e seancës në zyrë. m Nuk kishte sallë gjyqi të lire. m Tjetër. Paraqisni hollësitë: m Tjetër. Ju lutemi, paraqisni hollësitë:
Gjykim publik dhe përjashtim nga seanca:	A u përjashtua ndonjë nga seanca (publiku, shtypi, etj.)? m Po m Jo → Cila ishte arsyeja kryesore për përjashtimin? m Mungesë hapësire m Lloji i çështjes që kërkonte konfidencialitet (çështje familjare, siguri kombëtare, etj). Ju lutemi, paraqisni hollësitë: m Arsye tjetër. Ju lutemi, paraqisni hollësitë:
Përkthimi:	A nevojitej përkthim? m Po m Jo. → A u ofrua? m Po m Jo. Pse?
Përshkruani çdo problem tjetër që lidhet me infrastrukturën apo hyrjen fizike në seancë (p.sh. pamundësi hyrjeje për personat me paafhtësi, etj.)	

72. Ky seksion duhet të plotësohet për secilën seancë që është vëzhguar. Ndryshe nga seksioni i mëparshëm lidhur me informacion të përgjithshëm mbi çështjen, ky seksion synon në mbledhjen e të dhënave për çfarë ka ndodhur gjatë një seance të caktuar të një çështjeje.

73 Sipas Ligjit për Gjykatat Administrative, seancat duhen të mbahen në gjykatë pavarësisht mungesës së ndonjë pale.

3.3 ÇAKTIVE SEANCASH DHE SHTYRJE	
<p>A mbaroi çështja në këtë seancë apo do të vazhdojë në një datë tjetër?</p>	<p>m Çështja mbaroi në këtë séance (→ vijoni në seksionin 3.3) m Çështja do të vijojë në një datë tjetër. → A caktoi gjyqtari një datë për seancën tjetër? m Po m Jo → Data: A i konsultoi gjyqtari palët për të caktuar këtë datë? m Po m Jo</p>
<p>A ka ndodhur diçka e rëndësishme në seancë?⁷⁴</p> <p>(Seanca produktive përkundrejt atyre joproduktive)</p>	<p>m Po. Seanca u mbajt dhe diçka e rëndësishme ndodhi, por çështja do të vijojë të gjykohet në një datë të mëvonshme. Ju lutemi, shpjegoni pse:</p> <p>m Koha ishte e pamjaftueshme për të përfunduar seancën. m Nevojiten prova shtesë. m Nevojitet kohë për pretendimet përfundimtare. m Tranzicion për fazat e gjykimit (përfundim i seancës paraprake apo asaj dëgjimore) m Hapa procedurale lidhur me ekspertët (hartimi i raportit nga eksperti, leximi nga palët apo përgjigje nga eksperti për raportin) m Njoftimi i një pale të tretë m Kohë që ju ofrohet palëve për pajtim m Pritje e një vendimi nga Gjykata e Lartë m Të tjera ose të panjohura (→ Ju lutemi përdorni seksionin "informacion shtesë" më poshtë për të dhënë hollësi).</p> <p>m Jo. Seanca u caktuar për një date tjetër pa patur ndonjë zhvillim të rëndësishëm (shtyrje). Ju lutemi, shpjegoni pse:</p> <p>m Mungesë gjyqtari (arsye shëndetësore, familjare, trajnim) m Marrje provash shtesë m Mungesë avokati (arsye shëndetësore, familjare, trajnim) m Paditësi apo i padituri në mungesë pavarësisht se janë njoftuar rregullisht. m Kohë për të hartuar pretendimet përfundimtare. m Paditësi apo i padituri në mungesë pasi nuk janë njoftuar rregullisht. m Tranzicion midis fazave të gjykimit (përfundim i seancës paraprake apo dëgjimore) m Hapa procedurale lidhur me ekspertët (hartimi i raportit nga eksperti, leximi nga palët apo përgjigje nga eksperti për raportin) m Njoftim ekspertësh apo dëshmitarësh m Plotësim ankimi. m Njoftim i një pale të tretë m Kohë që ju ofrohet palëve për pajtim m Pritje e një vendimi nga Gjykata e Lartë m Të tjera ose të panjohura (→ Ju lutemi përdorni seksionin "informacion shtesë" më poshtë për të dhënë hollësi).</p>

74. Kjo pyetje synon të identifikojë arsyet kryesore për shtyrje dhe ricaktim datash për seancat duke mbajtur shënim për seancat që janë tërësisht joproduktive. Në një seancë joproduktive nuk paraqiten arsye, dokumente apo nuk qarkullojnë kërkesa, nuk merren prova dhe nuk bëhen kërkesa procedurale. Në të kundërt, çështja përparon, shkëmbehen dokumente apo qëndrime (si p.sh. diçka e rëndësishme ndodh gjatë seancës) atëherë seanca mund të klasifikohet si produktive.

Informacion shtesë për shtyrjen/caktimin e seancës tjetër ⁷⁵	
3.3.1 GJYKIM MBI BAZË DOKUMENTESH⁷⁶	
Nëse është e mundur, ju lutemi, shpjegoni llojin dhe datën e seancës që është zhvilluar mbi bazë dokumentesh me shkrim para kësaj seance.	
3.3.2 SJELLJA NË GJYKATË DHE SOLEMNITETI	
Sjellja në sallën e gjyqit	<p>A u zhvillua seanca siç duhet?</p> <p>m Yes - Po m No - Jo</p> <p>Nëse jo, cilat probleme u vëzhguan:</p> <p>m mungesë kontrolli nga gjyqësori</p> <p>m Ndërprerje</p> <p>m Telefonata</p> <p>m Gjyqtari i ashpër apo abuziv</p> <p>m Pakënaqësi ndaj gjykatës</p> <p>m Hapësira e sallës së gjyqit</p> <p>m Çështje të sigurisë</p> <p>m Të tjera (ju lutemi, përshkruajini)</p>
Regjistrimi i seancës:	<p>Si u regjistrua seanca? (zgjdhni të gjitha të mundshmet)</p> <p>m Regjistrim audio</p> <p>m Transkriptim me shkrim</p>
Kërkesa për përjashtim:	<p>A kërkoi ndonjë pale përjashtim të gjyqtarit?</p> <p>m Po m Jo</p> <p>→ Ju lutemi, paraqisni hollësitë:</p>
<p>Komente të tjera:</p> <p>Ju lutemi, shtoni çdo vëzhgim që lidhet me sjelljen e gjyqtarit, duke përfshirë vëzhgimet që lidhen me pavarësinë e gjyqtarit. Për shembull, a u ofroi gjyqtari mundësi të barabarta palëve? Nëse ka ndonjë shqetësim lidhur me pavarësinë apo paanësinë e gjyqtarit, ju lutemi, jepni arsytet për këtë shqetësim.</p>	

75 Ju lutemi paraqisni arsyetimin e detajuar për shtyrjen apo caktimin e seancës të radhës. Për shembull, nëse gjyqtari vendosi masa ndëshkuese ndaj një pale lidhur me shtyrjen apo caktimin e seancës së radhës, sqaroheni këtu së bashkur me informacione të tjera që lidhen me produktivitetin apo joproduktivitetin e seancës.

76 Ligji për Gjykatat Administrative parashikon mundësinë e zhvillimit të gjykimit në bazë shkresash. Nëse është e mundur, vëzhguesi duhet të përpiqet të ketë mundësi të jetë i pranishëm në këto gjykime për të hartuar një përmbledhje lidhur me këto shkresa.

3.4 THELBI I SEANCËS	
A ishte gjykata kompetente për të gjykuar çështjen?	m Po m Jo. (Ju lutemi, shpjegoni pse më poshtë).
Nëse është e mundur përshkruani vështirësitë për marrjen e dosjes administrative:	
Shpjegimet nga gjyqtarët	A e shpjegoi gjyqtari thelbin e mosmarrëveshjes? m Po m Jo. Gjyqtari nuk dha asnjë lloj shpjegimi për thelbin e çështjes. A dha gjyqtari hollësi për historikun procedural të çështjes? m Po m Jo. Gjyqtari nuk dha asnjë lloj shpjegimi për historikun procedural të çështjes.
A u mor ndonjë provë gjatë seancës?	m Po m Jo
A dëshmoi ndonjë palë gjatë seancës?	m Po m Jo
A dëshmoi ndonjë dëshmitar gjatë seancës?	m Po m Jo
A u paraqit ndonjë akt ekspertimi?	m Po m Jo
A vendosi gjykata ndonjë masë ndëshkuese ndaj ndonjë pale apo pjesëmarrësi në gjykim?	m Yes - Po m No – Jo → Ju lutemi, paraqisni hollësitë.
Çfarë ndodhi gjatë seancës? Ju lutemi, përshkruani çfarë ishte me rëndësi gjatë seancave. Nëse seanca ishte përgatitore, ju lutemi, përcaktoni cilat hapa përgatitorë u ndërmorën gjatë seancës. Përdorni një fletë të veçantë nëse nuk ju mjafton hapësira.	
3.5 VENDIME TË NDËRMJETME APO TË PËRKOHËSHME (JO PËRFUNDIMTARE)	
A u mor gjatë seancës ndonjë vendim i ndërmjetëm apo i përkohshëm (jo përfundimtar)? ⁷⁷	m Po m Jo. (→ ju lutemi, kaloni tek Seksioni 3.7)
Në cilën formë u dha vendimi?	m Vetëm me gojë. m Me shkrim.
Përmbledhje e vendimit:	
3.6 NDIKIMI I PRANISË SË VËZHGUESIT	
A nisi gjyqtari ndonjë bisedë/pati kontakt me vëzhguesin?	m Po m Jo → Ju lutemi, paraqisni hollësitë.
A nisën palët apo përfaqësuesit e tyre ndonjë bisedë/ patën kontakt me vëzhguesin?	m Po m Jo → Ju lutemi, paraqisni hollësitë.
Komente shtesë lidhur me praninë e vëzhguesit:	

77. Nëse ndonjë nga palët paraqet një kërkesë për masë të ndërmjetme apo të përkohëshme që hidhet poshtë nga gjykata, ju lutemi, paraqisni hollësitë për natyrën e kërkesës dhe arsyen e hedhjes poshtë të saj.

4. ZGJIDHJA PËRFUNDIMTARE E ÇËSHTJES ⁷⁸	
Si përfundoi çështja?	<p>m Vendim përfundimtar nga gjykata</p> <p>m Zgjidhje midis palëve (→ ju lutemi, paraqisni hollësitë nëse i keni dhe kaloni në Seksionin 5):</p> <p>m Ankuesi hoqi dorë nga ankimi (→ ju lutemi, paraqisni hollësitë nëse i keni dhe kaloni në Seksionin 5):</p> <p>m Të tjera (→ ju lutemi, paraqisni hollësitë nëse i keni dhe kaloni në Seksionin 5):</p>
4.1 VENDIMI PËRFUNDIMTAR NGA GJYKATA	
Vendimarrja:	<p>A u tërhoq gjykata për vendim?</p> <p>m Po</p> <p>m Jo</p> <p>Sa kohë zgjati?</p>
Forma e vendimit përfundimtar:	<p>m Vendim me shkrim.</p> <p>m Vendim vetëm me gojë.</p>
Gjykim me dyer të hapura:	<p>A dha gjykata një vendim publik për këtë çështje?</p> <p>m Po m Jo</p> <p>A shpalli <u>vetëm çfarë u vendos</u> për çështjen?</p> <p>m Po m Jo</p> <p>→ A do të jetë e mundur t'ju jepet një vendim i plotë, i arsyetuar?</p> <p>m Po. Data: m Jo</p>
Arsyetimi:	<p>A ishte vendimi i arsyetuar mjaftueshëm?</p> <p>m Po m Jo</p> <p>Ju lutemi, shpjegoni pse:</p>
A mori vëzhguesi një kopje të vendimit? ⁷⁹	m Po m Jo (nëse jo, shpjegoni përse):
Përmbledhje e vendimit:	
Vetëm për gjykimet në apel:	<p>m Vendimi i shkallës së parë u la në fuqi.</p> <p>m Vendimi i shkallës së parë u prish.</p>
Vendimi për çështjen e apeluar:	<p>m Çështja u dërgua për rigjykim.</p> <p>m Të tjera. Ju lutem, sqarojini:</p>
5. KOMENTE SHITESË	
Ju lutemi, paraqisni çdo lloj informacioni tjetër të rëndësishëm që lidhet me këtë çështje apo këtë seancë (nëse nevojitet përdorni një fletë tjetër):	

78 Jky seksion duhet plotësuar vetëm nëse gjykata jep një vendim përfundimtar në seancë. Nëse nuk jepet asnjë vendim përfundimtar, ju lutemi, përdorni seksionin e mësipërm mbi "vendimet e ndërmjetme dhe të përkohëshme".

76 Nëse është e mundur siguroni një kopje të vendimit përfundimtar dhe dorëzoni Menaxherit të Projektit kur të dorëzoni këtë formular.

Monitorimi i gjykimeve administrative 2015

Në gjykatat administrative të shkallës
së parë dhe Gjykatën e Apelit Administrativ

“Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
(OSBE) punon për stabilitet, zhvillim dhe demokraci
në 57 shtete pjesëmarrëse përmes dialogut politik
për vlera të përbashkëta dhe përmes punës
praktike që sjell një ndryshim jetëgjatë.”



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri
Sheraton Tirana Hotel, Kati I
Sheshi "Italia"
1010 Tiranë, Shqipëri
www.osce.org/albania